

*Nga Koleksioni i Risale-i Nuri*



# Tridhjetë e Tre Dritare



*Autor*

*Bediüzzaman Said Nursi*

*Sözler*

Said Nursi

## DRITARET E SË VËRTETËS

Tridhjetë e tre dritaret e së vërtetës

Hyrje

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ  
سَنُرِيهِمْ آيَاتِنَا فِي الْأَفَاقِ وَفِي أَنْفُسِهِمْ حَتَّى  
يَتَبَيَّنَ لَهُمْ أَنَّهُ الْحَقُّ أَوَلَمْ يَكْفِ بِرَبِّكَ أَنَّهُ  
عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ<sup>(1)</sup>

Shtrohet pyetje: Shkurtimisht duam që të na sqarosh kuptimin e këtyre dy ajeteve që e kanë temën për njësimin e Zotit të Madhëruar dhe për funksionet hyjnore të All-llahut xh.sh.. Duam të dimë se në çfarë mënyre njeriun paraqet si dëshmi për ekzistencën e njësimit të All-llahut xh.sh., në botërat maksimale dhe në atë minimale. Sepse sot ateistët shkuan shumë përpara deri aty sa të na thonë: Deri kur ne, duke hapur dhe ngritur duart do të bëjmë dua dhe do të themi:

وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ<sup>(1)</sup>

Përgjigje: Të gjitha të tridhjetë e tre “Fjalët”, që janë shkruar në librin “Fjalët”, janë të frymëzuara nga një pikë: nga të vërtetat e detit të këtyre ajeteve. Po qe se i vështroni me kujdes ato, mund të merrni edhe përgjigjen e duhur, megjithatë do të shënojmë një rreze të pikës së këtij deti.

Këtë pikë të rëndësishme do ta sqarojmë me një shembull:

Një person i mrekullueshëm kur vendos të ndërtojë një vilë superiore, së pari në një vend të fortë vendos themelet e saj duke i forcuar ato me hekura të pathyeshëm dhe e bën gati që t'ia marrë rezultatin për t'i përballuar nevojat edhe në ditët e ardhshme. Më pas e ndan atë në dhoma duke e rregulluar fare pa të meta. Më pas i hijeshon dhomat duke i qëndisur me lloj-lloj dekorimesh. Pastaj dhomat i ndriçon me llamba të ndryshme elektrike. Më pas për të treguar inteligjencën e tij, në secilën dhomë të pallatit të tij të bukur bën shndërrime e shpikje. Mandej për të parë secilën dhomë dhe për të marrë lajme nga banorët që banojnë nëpër to, me projekt të veçantë, nga dhoma e tij e posaçme, hap nga një dritare dhe lidh nga një telefon.

Njëllonj si në këtë shembull që dhamë, edhe Mjeshtri Madhështor, Sundimtari i Gjithëdijshëm, i Drejti Absolut “Ve lil-lahil methelul Ala” (Shembujt e All-llahut janë më të lartë) me një mijë e një emrat e Tij të amshueshëm “Esmaul Husna”, pra Krijuesi i pashoq, me vullnetin e Tij, me Gjithëdijen e Tij, vendos që të krijojë pallatin e madh të universit, së bashku me frutin e tij, njeriun. Së pari me principet e tij të paarritshme, vendosi themelet e kësaj ndërtese. Më pas i shpërndau nëpër shtresa të sipërme e të poshtme dhe me ligjin e Tij të caktimit, duke i shpërndarë nëpër lloj-lloj degësh, i formoi nëpër shumë forma. Më pas me urdhërin e tij të veçantë, i rregulloi secilin lloj dhe secilën shtresë të krijesave. Më pas krijoi secilin send me kushte të veçanta dhe e pajisi me një fomë të bukur, p.sh: qiellin me yje, sipërfaqen e tokës e hijeshoi me lule. Më pas funksionet e emrave të bukur i përhapi nëpër sheshe të parimeve të Tij të përgjithshme. Më pas që t'i ndihmojë individët që ankohen për shtrëngimet e parimeve të përgjithshme, dërgoi funksionet e mëshirës me titullin: I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti. Këto emra janë dorëshpëtues në çdo kohë e nevojë, për atë që duke u lutur e kthen kokën nga Ai. Më pas nga secila shtëpi, nga secila shtresë, nga secila botë, nga secili karvan, individ dhe send, ka hapur një dritare për të treguar Vetën dhe Njësinë e Tij dhe për secilën zemër ka vendosur nga një telefon. Tani për arsye që nuk na arrin fuqia, nuk do të bëjmë fjalë për të gjitha dritaret, ato do t'ia lëmë dijes superiore të All-llahut xh.sh.; ne do të hapim vetëm “Tridhjetë e tre dritare”, marrë nga “Fjala e tridhjetë e tretë” dhe “Letra e tridhjetë e tretë”. Unë duke bërë dobi nga shkël-qimi i këtyre ajeteve, e shkrova këtë libërth në mënyrë të përmbledhur, në formën e “Tridhjetë e tre dritareve”. Shkaku i këtij emri është numri i tespihëve të namazit; kujt nuk i mjafton kjo, le t'i referohet librit të quajtur “Sözler” (Fjalët), pasi aty mund ta gjejë më gjerë.

## DRITARJA E PARË

Ne po shohim shumë qartë se çdo send, veçanërisht qëniet e gjalla, kanë nevoja të shumëllojshme. Ato mund t'i përballojnë vetëm me ndihmën e një Fuqiploti, sepse ato tek ata arrijnë nga ana e papritur, pa pasur kurrfarë dijenije; ato arrijnë nga ajo anë që nuk arrinë fare dora e nevojtarëve, bile vijnë në kohën më të pëlqyeshme. Kurse fuqia e vetë nevojtarit nuk arrin në më të voglën prej tyre. Së pari shikojë veten tënde. Kush i përballon nevojat e shqisave të dukshme dhe ato që janë të padukshme, kush i solli ato pa të cilat nuk mund të qëndrosh fare?

Me veten tënde mund të krahasosh edhe krijesat e tjera të gjalla. Tani e kuptove se të gjithë ato, individualisht dëshmojnë për ekzistencën e një Zoti të Gjithëfuqishëm. Ashtu

siç tërësia e tyre që dëshmon si drita e diellit për vetë diellin, njëlloj edhe ato dëshmojnë për Njësimin e All-llahut, që mban funksione pa kurrfarë të mete. Ai është Bujar, Edukator dhe Mëshirëplotë. Këto që parashtruam për të mençurin, janë logjikë dhe argumente të pamohueshme.

Tani o mosbesues injorant dhe o mëkatar i pakujdesshëm! Në këto veprime të dukshme që krijohen me dije e me mëshirë, në krijimin e këtyre veprave, përveçse një të Gjithëdijshmi Absolut, çfarë shkakut tjetër mund të më paraqesësh ti? Këto a mund t'i bëjë natyra e shurdhër, apo fuqia e verbër, apo rastësia e pamend? Apo do të thuash se këto vetvetiu i kanë bërë atomet e pashpirtë? A mund të më sqarosh se kush i bëri këto?

●

## DRITARJA E DYTË

Në krijimin e çdo sendi, duke patur rrugë të ndryshme që të bëhen nga një send i papëlqyer e i shëmtuar, i ka krijuar, jo vetëm si trupa të përsosur, por edhe në fytyrën e tyre duket një bukuri e jashtëzakonshme; ku secili duket më i bukur se shoku.

Përshembull: Në fytyrën e vogël të secilit njeri, i ka vendosur një farë shenje të veçantë e një farë vule që të dallohet nga të tjerët. Jo vetëm në fytyrë, por edhe në të gjitha shqisat e brendshme si dhe ndjeshmëria dhe zëri i njeriut, pra shqisat mbajnë aftësi të ndryshme dhe marrin shije të ndryshme. Tani në krijimin e tyre duket shumë qartë një logjikë, që ndaj mijëra mundësive Ai ka parapëlqyer më të bukurën, më të hijshmen. Pra në atë fytyrë a nuk duket qartë vula e Njësimit të All-llahut xh.sh.? Megjithëse të gjitha fytyrat kanë pjesë të njëjta, shih hunda vesht e sytë janë në njëjtën vend, përsëri asnjëri fytyra nuk ngjan me ndonjërit tjetër. Pra këto vula, syrit dhe mendjes së njeriut, si individualisht ashtu edhe në pamjen e përgjithshme, i lajmërojnë Mjeshtër të Gjithëdijshëm.

O ateist, në cilin fabrikë mund t'i mbështetësh këto veprime superiore? A mund të gesh në to ndonjë grimcë falsitet?

●

## DRITARJA E TRETË

Në sipërfaqen e tokës marrin jetë të gjitha llojet e bimëve dhe të kafshëve, që përbëjnë një karvan të madh prej katërqind mijë llojesh\*; ushtarë që secili prej tyre mban fytyrë të ndryshme, jetojnë me ushqime të ndryshme, mbartin armë të ndryshme, bëjnë ushtrime të ndryshme, çlirohen në kohëra të ndryshme dhe vazhdojnë pa gabim duke vijuar me një rregullsi të përsosur, pa u harruar asgjë. Pra kjo është një vull në të cilën nuk mund të

hyjë kurrfarë dyshimi. A nuk është kjo një vulë e shndritshme për të vërtetuar Njësimin e Zotit të Madhëruar tamam si dielli?!

Këto veprime kush mund t'i bëjë përveç Një Fuqiploti Absolut, përveç një Dijetari Absolut dhe një të Gjithëdijshti gjeni? Flisni kujt mund t'i arrijë fuqia që të shoqërohet në këto veprime superiore?! Sepse sjellja e ngatërruar e këtyre fenomeneve, tregon se përveç All-llahut të Madhëruar, askush nuk mund t'i drejtojë dhe t'i sundojë këto që treguam më sipër. Po qe se dikush paraqet ndonjë mendim që mund të ndërhyjë, nuk bën gjë tjetër veçse një gafë të paskrupullt.

Me sekretin e ajetit:

(1) فَارْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَى مِنْ فُطُورٍ

në të gjithë universin nuk mund të gjesh asnjë shenjë ngatërrimi, d.m.th. deri tani askush nuk ka mundur ta përziejë gishtin.

•

#### DRITARJA E KATËRT

Të gjithë farërat në krijimin e tyre bartin një aftësi dhe luten me gjuhën e aftësisë së tyre, një lutje e pranueshme; njëllon janë edhe lutjet e të gjitha kafshëve që kërkojnë t'i plotësohen nevojat që kanë; shtoji këtyre edhe lutjet e të sëmurve që bëjnë me gjuhën e dobësisë së tyre, lutje të cilat meritojnë që të mos kthehen prapa. Këto janë një fuqi e jashtëzakonshme dhe një vulë e fortë për ekzistencën e një Zoti të Madhëruar. Ashtu edhe tërësia e tyre, duke na kthyer kokën nga ato, na tregojnë në shkallën më të lartë për Krijuesin Mëshirëplotë dhe Bujarin që nuk ua kthen lutjet mbrapa.

•

#### DRITARJA E PESTË

Ne po shohim se çdo gjë, veçanërisht gjallesat, krijohen nga gjëra shumë të thjeshta, madje për një kohë shumë të shkurtër. Normalisht çështjet që krijohen nga gjëra shumë të thjeshta, duhet të jenë pa mjeshtri dhe pa formë, ndërsa që të krijohen këto gjallesa lind nevoja për mjeshtri të ndryshme, për punë të gjatë dhe vegla të teknikës së lartë. Kurse Fuqiploti të gjitha këto i krijon edhe pa ato, bile me një mjeshtri dhe bukuri të përsosur sa s'ta merr mendja. Tani secili nga këto gjallesa që krijohen me një formë superiore, ashtu

siç secila prej tyre tregojnë dhe dëshmojnë për ekzistencën e domosdoshme të një Mjeshtri të Gjithëdijshtëm, duke theksuar se është një Edukator i pashoq, ashtu edhe tërësia e këtyre gjallesave në një formë akoma më të shkëlqyer, tregon dhe thekson Njësine e Tij.

Tani o ti mohues i pakujdesshëm! Paraqitu ta shohim se me çfarë na i sqaron këto! A thua do t'ia mbështesësh natyrës që është si ti e pamend, e paaftë dhe e paditur?! Apo duke pranuar njëmijë të pamundurat përnjeherësh edhe Emrin e Mjeshtrit po ia ngjet natyrës dhe në këtë mënyrë duke shndërruar emrin e Krijuesit, mrekullitë e Tij, të çuditshme ia mbështet natyrës.

●

## DRITARJA E GJASHTË

Ky ajet, duke theksuar ekzistencën dhe njësimin Hyjnor na hap një dritare të madhe për të parë emrin e Madhërueshëm të All-llahut xh.sh.. Edhe përmbledhja e këtij ajeti ka këtë qëllim.

Në universin madhështor, nëpër të gjitha botërat janë shtresa minimale dhe ato maksimale, që unanimisht arrijnë në të njëjtin qëllim, d.m.th. theksojnë se kanë dalë vetëm nga edukimi i një Mjeshtri të Gjithëdijshtëm.

Astronomia na tregon se nëpër qiej dhe nëpër kozmos po bëhen shumë qarkullime të rregullta për një qëllim të caktuar, për të treguar ekzistencën e një Zoti të Madhërishëm; njëlloj edhe në sipërfaqen e tokës, gjeografia dëshmon se për t'u formuar stinët, bota madhështore sillet duke vrapuar rreth diellit dhe rreth vetes së saj, për t'u formuar dita dhe nata, me një precizion maksimal, që të mos bëjë ndonjë goditje me planetët e tjerë.

Si thoni, a nuk tregojnë këto veprime që, ekziston medoemos një Fuqiplotë Madhështor; dhe ashtu si në sipërfaqen e tokës ashtu edhe nëpër detëra, krijesat e gjalla, me një mëshirë superiore dhe me një ekuilibrim të mprehtë, po përballojnë nevojat e tyre, po i jepet rrësku dhe veshmbathja e tyre. E njëjta fuqi, me përsosmërinë superiore, i ka mësuar shpendët të fluturojnë; lopën e ka bërë një fabrikë qumështi, mishi dhe kosi; pulën një fabrikë zogu dhe vezësh; peshkun e ka mësuar si të qëndrojë dhe të ushqehet nëpër ujëra, punë për të cilat ne nuk kemi zotësi.

Ashtu siç secila prej tyre medoemos dëshmon për ekzistencën e një Fuqiploti të Gjithëdijshtëm, njësoj edhe tërësia e tyre në një sipërfaqe më të gjerë, dëshmojnë për Madhërinë e një Hyjnije, që aftësia e Tij arrin t'i edukojë me përsosmëri të tillë, sa që mendja ynë nuk mund ta konceptojë atë. Njëlloj edhe nëpër kopshtet e vreshtat që Ai ka krijuar bimët dhe lulet e rregullta, që vazhdimisht i qeshin fytyrës sonë duke na paraqitur fruta të shijshme si dhe lulet e bukura, të cilat na dalin përpara me piktura të shumëllojshme, këto ashtu siç një nga një na tregojnë për një Mjeshtër të Gjithëdijshtëm,

ashtu edhe tërësia e tyre në një kor të madh, tregojnë Edukatorin e tyre superior dhe Gjithëmëshirshmërinë e Tij të Bukur. Dhe ashtu siç mjegullat formohen në qiell për një qëllim të caktuar, edhe pikat e vogla të shiut bartin dobëtë dhe rëndësitë e mëdha, duke sjellë fruta të vlefshme. Ato sa numri i pikave, tregojnë se medoemos është e nevojshme të ekzistojë një Mjeshtër i Gjithëdijshëm. Ashtu edhe malet që janë nëpër botë edhe minierat që janë brenda tyre me elemente, të ndryshme me përgatitjen e rezervimeve të tyre të shumëllojshme bërtasin me një zë të fortë në madhësinë e maleve dhe tregojnë se është e domosdoshme të ekzistojë një Mjeshtër i Gjithëdijshëm dhe një Edukator i përsosur, pra All-llahu i Madhëruar.

Në këtë mënyrë edhe shkretëtirat, edhe kodrat e vogla, që Ai i ka hijeshuar me lule me piktura të larmishme, edhe këto një nga një medoemos na tregojnë për ekzistencën e një Mjeshtri të Gjithëdijshëm, që është vetëm Ai që i bën këto; njëlloj edhe tërësia e këtyre akoma më mirë lajmëron për një Mbret Madhështor dhe për Edukatën e Tij të përsosur. Në këtë mënyrë në të gjithë fletët e drurëve dhe të bimëve me forma dhe me gjendje të ndryshme dhe me lëvizjet e rregullta të tyre dhe me sasinë e fletëve, medoemos tregojnë për ekzistencën e Mjeshtrit të Gjithëdijshëm. Dhe siç në zanafillë, në mitrën e nënave gjendja e fillimit të vogëlushëve dhe lëvizja e tyre e rregullt dhe pajisja e tyre me vegla të ndryshme dhe me largpamësinë përgatitur për të dhënë rezultatin dhe frutet më të bukura, përsëri secili dëshmon për ekzistencën e një Mjeshtri Gjenial duke theksuar dhe dëshmuar për Njësimin e Tij, njëlloj në sipërfaqen e gjerë tërësia e tyre tregon për konceptimin e fuqisë, gjerësinë e dijes, bukurinë e mjeshtresë së Tij dhe përsosmërinë e Edukatës së Tij. Madje edhe në trupat e kafshëve është vendosur shpirti por edhe veset e këqija; ato duke i pajisur me shqisa të shu-mëllojshme, me një dije superiore janë vendosur pikërisht në vendet e duhura, duke i angazhuar me detyrime; përsëri sikurse sasia e kafshëve, ndoshta sanumri i shqisave të tyre medoemos tregojnë për ekzistencën e një Mjeshtrit të Gjithëdijshëm, njëlloj edhe tërësia e tyre në një formë më të shkëlqyer tregojnë për bukurinë e mëshirës dhe për përsosmërinë e Edukatës së Tij.

Ja çdo revelatë dhe frymëzim që bëhet nëpër zemra: n.q.s. është njeri, zemrës së tij ia ka laj-mëruar çdo lloj shkence; n.q.s. është kafshë, asaj shpirtërisht i ka mësuar dijet për të përmbushur nevojat e duhura, vjen nga një anë e fshehtë dhe medoemos ndihet nevoja që të pranohet ekzistenca e një Mëshirëploti dhe Edukatori. Po kështu edhe shqisave, p.sh. syrit i ka dhënë aftësi që t'i mbledhë lulet shpirtërore të universit ashtu siç i mbledhë rrezet pasqyra; të gjitha shqisat e dukshme dhe ato të padukshme janë nga një çelës i horizonteve apo fushave të ndryshme, përsëri edhe këto si drita për diellin, medoemos dëshmojnë për ekzistencën e Mjeshtrit të Gjithëdijshëm, për Krijuesin e Bukur dhe Mëshirëplotë dhe për Furnizuesin Bujar.

Tani prej këtyre dymbëdhjetë dritareve të "dritares së gjashtë" që radhitëm, hapet një dritare e madhe për të treguar Njësimin e Zotit dhe formon një të vërtetë me dymbëdhjetë ngjyra, që në këtë mënyrë tregon përsosmërinë e All-llahut të Madhërueshëm.

Tani o ti mohues i pafat! Me çka mund ta mbyllësh dhe si mund ta shuash këtë dritë të shëndritshme që është si dielli madhështor, pra cilën perde mund t'ia ngresh kësaj

dritareje që është sa rruzulli tokësor, ndoshta sa rrethi i gjerë i saj që formohen stinët duke lëvizur përreth diellit (me shpejtësi 108.000 km në orë)?!...

●

## DRITARJA E SHTATË

Që edhe një argument, siç është rregulli superior i krijesave që janë stërvitur në faqen e universit; hijeshija e përsosur e tyre, lehtësia në krijimin e tyre, përngjashmëria me njëritjetrin, tregohet unanimisht për një Krijues të vetëm.

Ky a nuk është një argument i gjerë për të treguar se duhet të dëshmojmë për ekzistencën e një Mjeshtrit të Madh dhe fuqinë e Tij të pashoqe?!

Njëlloj na çudit edhe krijimi dhe kombinimi i rregullt nga elemente të vdekura, të cilat si në sasinë e elementeve të cilat medoemos dëshmojnë dhe tregojnë për ekzistencën e një Mjeshtri të Gjithëmëshirshëm dhe për Njësinë e Tij, por edhe në tërësinë e tyre shumë më mirë, me një formë më të shkëlqyer tregojnë për Njësimin e Tij dhe fuqinë e Tij të përsosur. Biologët thonë se formimi i tyre është një kombinim, kurse në të vërtetë gjërat dhe elementet e vdekura nga ngatërresa të pafundme po ndahen me një rregullsi superiore. P.sh. rrënjët dhe farërat duke qenë shumë të ngatërruara në tokë lulëzojnë pa gabim e ngatërresë, madje po dalin në shesh duke mbajtur veçantitë e trupave të tyre, duke marrë frymëzim që të hyjnë nëpër trupa, fletë, lule dhe fruta. Pra ndarja e elementëve të ngatërruar dhe hyrja e ushqimeve nëpër trupa, si dhe formimi i qelizave dhe ndarja e tyre me një ekuilibrim superior, prapë medoemos dëshmojnë për ekzistencën e një të Gjithëdijsmi Absolut dhe për fuqinë e një Fuqiploti Absolut dhe për Njësimin e Tij të pashoq.

Tani Ai, Fuqiploti, për të marrë prodhime të reja, botërat e atomeve i ka sjellë si një arë e gjerë që me Gjithëdijen e Tij e mbjedh dhe e korr në çdo çast. Atomet që janë gjëra të vdekura dhe të paafta i sjell të bëjnë punë të logjikshme dhe të përsosura; prapë këto punë medoemos tregojnë për Fuqiplotin e Madhërishëm dhe për një Mjeshtër të Përsosur. Tani edhe këto katër rrugë për të njohur Njësimin e Zotit të Madhëruar janë një argument i madh që të hapin një dritare të madhe që ta shohësh dhe të kujtohesh për Zotin tënd.

Tani o ti i pakujdesshmi i pafat! Prapë po që se nuk do ta shohësh Atë, hidhe mendjen dhe bëhu kafshë dhe vetëm në këtë mënyrë mund të shpëtosh...

●

## DRITARJA E TETË

Të gjithë shpirtrat e ndritur të llojit të njerëzve të radhës së parë, që janë Profetët (alejhimus-selam), duke u mbështetur në mrekullitë e tyre të qarta dhe të gjithë kryetarët e zemrave të ndritura që janë evlijatë, duke u mbështetur në kerametet e tyre (mrekullia e gradës së dytë) dhe të gjithë mendjet e ndritura që janë besimtarët e fortë dhe duke u mbështetur në hulumtimet e tyre, dëshmojnë dhe hapin një dritare të madhe, ku duke parë nga ajo, të shtyjnë doemos të dëshmosh Njësimin e Zotit dhe të theksosh se Ai është Krijuesi dhe Edukatori superior i secilit send; dëshmia e tyre është një dritare e shkëlqyer dhe shumë e madhe. Ato me shprehjet e ndritura dëshmojnë vazhdimisht dhe na tregojnë pozitën e Edukatës së All-llahut xh.sh..

Tani o mohues i pafat, që s'po dëgjon fjalën e këtyre njerëzve të posaçëm, kujt je duke iu mbështetur? Apo po i mbyll sytë në mesin e ditës dhe po mendon se u bë natë?...

•

## DRITARJA E NËNTË

Një argument i fortë është edhe ibadeti (adhurimi i përgjithshëm i krijesave) që është duke na treguar shumë qartë se është një i Adhures i pakufizuar. Ja pra personat që shkojnë nëpër botëra shpirtërore dhe nëpër fshehtësira, shpirtërisht takohen me melekët (engjëjt) me pamjen e të cilëve konstatohet se edhe melekët, me një përsosmëri të jashtëzakonshme, bëjnë adhurimin e duhur ndaj Krijuesit; jo vetëm ato, por të gjitha krijesat e gjalla bëjnë rregullisht adhurim, përsëri konsta-tohet se me një përkulje të përsosur edhe elementet e pashpirt duke bërë shërbimin e duhur ndaj Krijuesit, po bëjnë adhurimin që u takon. Pra këto që ua treguam, ashtu siç secila medoemos dëshmon se është një i Adhurar i përgjithshëm dhe një Zot i pashoq që meriton adhurimin ndaj Tij, po ashtu edhe karvanet e tyre me një formë të qartë dëshmojnë për një të Adhurar të pakufishëm.

Përfundimisht të gjitha dijet e vërteta të dijetarëve, të gjitha falenderimet e frutshme të falenderuesve, të gjitha frymëzimet dhe ngushëllimet e atyre që vazhdimisht e përmendin All-llahun xh.sh. dhe të gjitha falenderimet që janë shkaku i shtesës së mirësive, të gjithë besimtarët që pa irritim besojnë në Një Zot, jetojnë akoma duke vërtetuar çështjen e tyre dhe të gjithë ato që theksojnë se Ai është dashamiri i të gjithë dashamirëve dhe ideali i të gjithë idealistëve. Pra të gjitha krijesat dëshmojnë për një Zot të vetëm, duke theksuar se Ai nuk bie nga goja e secilit (ndërsa edhe shqisat, qelizat dhe atomet që janë në trupin e ateistit dëshmojnë për Atë) këto duke u mbështetur tërësisht në emrat e Zotit (Esmā-ul Husnā); dëshmojnë se Ai është i vetëm, i dashur, qëllimi kryesor për secilin; Ai i mban të gjithë funksionet nga parafillimi deri në përjetësi, Ai është i Adhurari i Vetëm dhe në këtë mënyrë të gjitha krijesat duke bërë adhurim, i luten Atij dhe gjejnë ngushëllim. Pra edhe me këto tre argumente hapet një dritare e madhe që të bindesh në Njësimin e Tij.

وَأَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا  
 لَكُمْ وَسَخَّرَ لَكُمُ الْفُلْكَ لِتَجْرِيَ فِي الْبَحْرِ بِأَمْرِهِ  
 وَسَخَّرَ لَكُمُ الْأَنْهَارَ ﴿١٠﴾ وَسَخَّرَ لَكُمُ الشَّمْسَ  
 وَالْقَمَرَ دَائِبَيْنِ وَسَخَّرَ لَكُمُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ ﴿١١﴾  
 وَآتَاكُم مِّنْ كُلِّ مَا سَأَلْتُمُوهُ وَإِن تَعُدُّوا نِعْمَتَ اللَّهِ لَا تَحْصُوهَا <sup>(1)</sup>

Ja nëpër univers, përmes atyre që bëhen ndihma mes krijesave dhe mbështetja tek njëri-tjetri, tregohet se të gjithë krijesat i ka edukuar Njëri, ato i rregullon Dikush, lëvizin nën sundimin e Njërit dhe të gjitha janë shërbëtorë të Njërit. Ai është Padron i Vetëm. Sepse duke filluar nga dielli që lëviz dhe me urdhërin e Një Edukatorit piquen ushqimet e gjallesave dhe duke vazhduar, detyrën e kalendarit që kryen Hëna deri tek drita, ajri dhe ushqimet e të gjithë të gjallëve që vrapojnë t'u ndihmojnë nevojtarëve; deri bimët që vrapojnë në ndihmë të kafshëve, kafshët që vrapojnë në ndihmë të njerëzve, deri edhe tek pjesët e trupit që ndihmojnë njëra-tjetrën, madje deri edhe tek atomet e ushqimit që vrapojnë nëpër qelizat e trupit dhe ky ligj i ndihmës vazhdon edhe më tej, ku tek të gjitha këto na tregohet se nuk është e mundur që gjërat e pashpirt t'i bëjnë këto punë vetvetiu. Këto sigurisht bëhen nën një ligj të mëshirës, nën një princip të ndihmës dhe nën një dorë bujare dhe vetëm në këtë mënyrë nuk prishet rregulli i këtyre veprave, ku duke i dëgjuar njëri-tjetrit zërin e nevojës ia plotësojnë mungesat që kanë. Me siguri dhe me të vërtetë këto mund t'i bëjë Ai që nuk ka nevojën e askujt, fuqia e të cilit është e pakufizuar dhe dituria e të cilit i koncepton të gjitha; Ai është Mëshirëploti Absolut dhe Bujaria e Tij është absolute. Argumentet që rradhitem më lart na shtyjnë medoemos ta pranojmë ekzistencën e Zotit sepse shumica e këtyre ndihmësave janë të pashpirt, janë shërbëtorët dhe nëpunësit e Zotit, që mbajnë funksione të radhitur më parë.

Tani o filozofët e pafatë që keni rënë në humbje! Çfarë mund t'i thoni kësaj dritareje, kësaj pune a ka mundësi t'i përzihet rastësia që paraqitni ju.

## DRITARJA E NJËMBËDHJETË

(1) **الْأَبْذِكْرُ اللَّهُ تَطْمِئِنُّ الْقُلُوبُ**

Shpëtimi nga torturat e ndëshkimet dhe shpëtimi shpirtërisht i zemrave kur përballet me shtrëngime, bëhet vetëm me besim në një Krijues dhe kur krijimin e të gjithë krijesave e mbështet në një mjeshtër dhe kënaqësia më e madhe e njerut është atëherë kur e përmend vetëm Atë.

Sepse universi i paskaj, po qe se nuk pranohet i krijuar nga një Zot, siç është vërtetuar edhe në “Fjalën e njëzetedytë”, secilin send duhet t’ia japësh gjërave të panumërta. Në këtë rast krijimi i një çështjeje të vetme bëhet i vështirë sikurse kur krijon universin madhështor, sepse po qe se atë e mbështet tek All-llahu i Vetëm, ia ke mbështetur një personi të vetëm dhe po qe se nuk ia jep Atij, atëherë krijimin e secilit send ia ke dhënë gjërave të panumërta. Në këtë rast për të zotëruar një frut të vetëm bëhet e vështirë sikur krijon gjithësinë, ndoshta bëhet akoma më me vështirësi, sepse ashtu sikurse pajimin e një ushtari kur e mbështet në njëqind vende, atëherë edhe numri i problemeve arrin në njëqind; përkundrazi kur pajimin e një ushtari e mbështet tek një oficer i vetëm, atëherë bëhet si me qenë i një personi të vetëm. Njëlloj edhe në krijimin e një çështjeje, kur mblidhen disa shkaqe, bëhet i vështirë sa krijimi i njëqid të tjerave. Gjithashtu edhe shpjegimin e shumë gjërave kur ia jep një personi të vetëm, atëherë bëhet njëqind herë më i lehtë. Kurioziteti kërkon për të mësuar krijimin e gjërave, e nga ai mund të shpëtosh vetëm kur njeh dhe beson një Zot të vetëm. Meqë mosbesimi mban probleme të panumërta, atëherë me të vërtetë ajo rrugë është pa rrugëdalje dhe në të mos kërko të vërteta. Meqë besimi në një Zot të vetëm lehtëson rrugët që të njohësh krijimin e krijesave, me të vërtetë në këtë botë nuk duhet ta braktisesh atë që e ke për detyrë.

Tani o ti i pafat që ke rënë në rrugën e devijimit! Shiko se sa me errësirë dhe me dhimbje është ajo rrugë! Çfarë vështirësie pate dhe kush të shtyu që të futesh në të? Dhe shihe mirë se sa e lehtë është rruga e besimit! Aty vazhdo dhe shpëto!

## DRITARJA E DYMBËDHJETË

(1) سَبِّحْ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى ۝ الَّذِي خَلَقَ فَسَوَّى ۝ وَالَّذِي قَدَّرَ فَهَدَى

Me sekretin e këtij ajeti, në të gjitha krijesat, veçanërisht në ato të gjalla, duket shumë qartë bukuria e Krijuesit. Secila krijesë është krijuar shumë normal, sikurse të kenë dalë nga kallëpi, duke marrë një formë shumë të bukur të pajisur me vlera të shumëllojshme; ku nga shumë alternativa është parapëlqyer forma më e bukur. Duke pasur harqe dhe pjesë të lakuara nëpër to, tregojnë Mjeshttrin e tyre të Patëmeta; duke hyrë në shumë forma dhe duke veshur rroba të ndryshme në jetën e tyre. Përsëri këtu vihet re projektimi i caktuar i inxhinierit të tyre. Shihet qartë se këto fenomene me fuqinë e Tij kanë marrë formë dhe kjo tegon se i Gjithëdijshti me projektin e Tij, i ka bërë të tilla dhe këto japin shenjë se me siguri janë artet që bartin vulën e Fuqplotit Madhështor dhe Dijetarit të pagabimtë; këto me gjuhët e tyre të panumërta, tregojnë dhe dëshmojnë se ika krijuar Krijuesi Madhështor.

Ti hapi sytë dhe shihe trupin tënd! Çfarë re-zultati japin veglat e trupit me lakimet e tij, që ia sheh dobinë si jo më mirë! Në krijimin tënd shihe Fuqinë superiore!

•

## DRITARJA E TREMBËDHJETË

(1) وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

Me sekretin e këtij ajeti, secili send me gjuhën e tij të veçantë, e vërteton dhe e përmend Krijuesin e vet. Ja pra, çdo qenie bën tespah me gjuhën apo me qenien e saj dhe kuptohet që ekziston një Krijues që i meriton ato. Kështu argumentet vijnë nga të katër anët, duke mos lënë asnjë dyshim, ku ndërgjegjja e njeriut të drejtë nuk i mohon ato më. Ti po qe se nuk më beson, shih argumentet e panumërta të krijimit, ku në forma të ndryshme japin shenjë tamam si rrathët kur janë njeri brenda tjetrit, të drejtuar nga një qendër dhe me forma të ndryshme. Këto qenie që vijnë janë pajisur me nga një argument edhe nëse janë me masa minimale, krijimi i tyre është një gjuhë e fortë që dëshmon për Atë dhe jetën e Tij të pasosur, është një gjuhë që vazhdimisht e përmend Atë. Siç kemi treguar edhe në “Fjalën e njëzetekatërt”, duke përmendur Atë që e vazhdon ekzistencën secila qenie me gjuhën e saj i bën zikër All-llahut xh.sh. dhe ky është një argument i qartë si drita që

vërteton diellin. A s'është ajo një shenjë e mjaftueshme për të argumentuar Zotin e Patëmeta?

●

## DRITARJA E KATËRMBËDHJETË

Me sekretin e këtij ajeti, çdo gjë për secilin send dhe për çdo kërkesë është nevojtar i Tij. Ja pra, në univers shikojmë që qeniet janë në dobësi e në paaftësi të pafundme, kurse në veprimtarinë e tyre shihet shumë qartë një fuqi dhe një aftësi e madhe. Në shembull kemi gjallërimin e farërave dhe të rrënjëve. Ato në vetvete duke qenë të paafta fare, kur lulëzojnë në tokën e thatë na tregojnë një pasuri të jashtëzakonshme.

Kurse në stinën e dimrit kur toka ka ujë të bollshëm, ato qëndrojnë në gjendje të varfër dhe degët e tyre u varen poshtë; përkundrazi në stinën e pranverës dhe të verës kur toka është e thatë ato gjallërohen dhe na tregojnë pasurinë e tyre.

Elementet duke qenë absolutisht të vdekura, kur detyrohen e bëjnë punë nëpër gjëra të ndryshme lajmërojnë një fuqi dhe një gjallëri të habitshme.

Në lëvizjen e secilit send, po duket një men-talitet dhe vetëdije e pafundme, kurse në të vërtetë ato janë gjëra pa dije, duke marrë që nga atomi dhe deri tek yjet që lëvizin sipas një qëllimi dhe një dobie.

Tani brenda dobësisë ka fuqi; brenda varfërisë ka pasuri; tek gjërat e vdekura ka jetë dhe tek gjërat e paditura ka vepra të vetëdijshme. Të gjitha këto që treguam nga katër anë, hapin dritare që të shohin medoemos se në këto është duke sunduar një Fuqi Absolute, një Pronar Absolut dhe një Dijetar Absolut. Pra tërësia e tyre në një formë më të gjerë, a nuk na tregon për bulevardin e shndritshëm?!

Tani ti i pakujdesshëm që ke rënë në batakun e pakujdesisë! Që ta njohësh hyjninë tënde, po qe se ti nuk e lë mendimin e natyrës, atëhere përderisa të gjithë atomet kanë nevojë të mbartin fuqinë e pafundme dhe diturinë gjeniale, secili send duhet të bartë një aftësi të tillë që përnjëherësh duhet ta shohë, ta dijë dhe ta drejtojë secilin send.

## DRITARJA E PESËMBËDHJETË

(1) الَّذِي أَحْسَنَ كُلَّ شَيْءٍ خَلَقَهُ

Me sekretin e këtij ajeti çdo send sipas gjendjes së tij, me rregulla të ekuilibruar me preçizion maksimal e të përsosur, mban aftësi dhe pajisje të jashtëzakonshme, të cilat ia ka dhënë Zoti; aftësi dhe pajisje me cilësinë e duhur. Duke i bërë këto, i ka zgjedhur dhe e ka veshur me formën më të mirë dhe me rrugën më të shkurtër dhe më të lehtë; dhe përdorimin e tij e ka sjellë po ashtu në mënyrën më të lehtë. P.sh., shikoj “rrobat” e shpendëve që vazhdimisht i përdorin dhe i lëkundin ato me lehtësi; atyre i ka dhënë një trup dhe i ka veshur edhe ekonomikisht në një farë forme. Në sasinë dhe gjuhët e këtyre gjërave, medoemos dëshmohet dhe theksohet ekzistenca e Fuqplotit dhe të Gjithëdijshtit Absolut.

●

## DRITARJA E GJASHTËMBËDHJETË

Shikoje sipërfaqen e tokës në stinët e ndryshme. Me një rregull superior dhe me masa të holla siç janë shpikur këto krijesa, pa dyshim tregojnë një rregull të përgjithshëm edhe Rregulluesin e tyre. Ashtu si puna që nuk bëhet pa punëtor, ashtu edhe rregulli dëshmon për një Rregullator të tij. Dhe brenda perdes së përsosmërive të tyre, a nuk duket një hijeshi që me siguri tregon për një ndihmës pa të meta dhe për një Krijues Bujar dhe Ndihmëtar Absolut? Sikur ta shohësh edhe pas perdes së ndihmës, duket se ajo nuk është e kufizuar për disa pjesë të veçanta, por është një bamirësi dhe një dhurim i përgjithshëm dhe kjo dëshmon për mëshirën e gjerë, pra medoemos tregojnë dhe dëshmojnë për një Mëshirëplotë të Gjithmëshirshëm. Në këtë rast, kur krijesat dalin përmbi perden e mëshirës, duket se të gjithë nevojtarëve të gjallë po i arrin rrësku, bile tamam në kohën e duhur dhe të pëlqyer; edhe kjo tregon për Bujarin, Edukatorin dhe Furnizuesin.

Ja pra këtyre krijesave, që krijohen dhe edu-kohen në sipërfaqen e tokës me përsosmërinë me të madhe, i arrin ndihma dhe mëshira; i arrin dhurata dhe ndihma e ushqimit; pra të gjitha krijesat, të cilat një nga një medoemos dëshmojnë për Mjeshttrin e Gjithëdijshtëm dhe për Mëshirëplotin Furnizues. Gjithashtu edhe në sipërfaqen e tokës që duket rregulli i krijuar sipas një qëllimi të caktuar, ua sjell atyre ndihmën e përgjithshme, duke parapëlqyer anën e dobishme, duke u ofruar mëshirën e Tij pa mangësi. Pra merre parasysh Mëshirën e furnizimit të krijesave dhe vështro! Ashtu siç formojnë shtatë ngjyrat dritën e diellit dhe ajo dritë medoemos na tregon se është një diell, ku njëlloj edhe brenda këtyre bukurive tregohet ndihma dhe brenda saj tregohet mëshira dhe brenda

mëshirës duhet të shohësh furnizimin dhe rrëskun e të gjitha krijesave. Këto shumë qartë dhe padyshim ta ndriçojnë rrugën që të zësh besë se këto i ka bërë një i Gjithëdijshtëm, Bujar, Mëshirëplotë dhe Furnizues.

Tani ti o mohues i pakujdesshëm! Kujt ia mbështet dhe me çfarë na i tregon këto punë të mrekullueshme që ke para syve? Apo do t'ia mbështesësh ndonjë rastësie të një vagabondi si ti? Apo ndonjë force të verbër që është si zemra jote? Apo ia mbështet natyrës që është e shurdhër si koka jote? Apo ia mbështet shkaqeve injorante e të pashpirt që janë si ti? Apo po i thua natyrë Krijuesit të këtyre mrekullive dhe fuqisë së Tij të pastër, të lartë, të patëmeta e të amshuar, të një Zoti Fuqplotë, të Dijshmit, Dëgjuesit dhe Vështuesit?! Është një gabim i pafund që mrekullitë e Zotit t'ia japësh natyrës së dobët, injorante, të shurdhër, të verbër dhe të krijuar nga tjetërkush. Me çfarë fuqie mund ta shuash këtë të vërtetë që është si dielli? Dhe ç'perde mund të ngresh mbi to?

•

#### DRITARJA E SHTATËMBËDHJETË

(1) **إِنَّ فِي السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ لَآيَاتٍ لِلْمُؤْمِنِينَ**

Në sipërfaqen e tokës në stinën e verës shohim se nevojat e shpjegimit të çështjeve dhe komplikimet e ndryshme, po i sundon bujaria e pafundme, që vijon nga rregulli dhe radha e pagabimtë. Tani shih si argument bimët që e kanë hijeshuar sipërfaqen e tokës.

Megjithëse puna e shpejtë nevojit çrregullimin dhe çështjet po krijohen me një shpejtësi të jashtëzakonshme, ato nuk e humbin rregullin e tyre. Si argument shih drurët frutorë, të cilët e kanë hijeshuar botën.

Gjërat kur janë të shumta, duhet ta humbin vlerën dhe ndoshta nevojitet të bëhen më të këqija, ndërsa në të vërtetë ato janë shumë të mrekullueshme. Si argument vështro lulet që me lloj-lloj pikturash e kanë hijeshuar tokën.

Shpjegimet e këtyre çështjeve nevojitet të jenë të thjeshta, ndërsa ato duke u shpikur shumë shpesh, kanë nevojë për ekspertizë, por në fakt ato po mbartin mjeshtri superiore. Si argument shih sëndukët e pajisjeve të drurëve që kanë hijeshuar botën, pra farërat që mbartin programin dhe historinë e drurëve. Shih edhe elementet e ndryshme që në fakt nevojitin mosbashkimin. Ndërsa ato bashkohen si jo më mirë. Si argument shih bimët që janë mbjellë nëpër sipërfaqen e botës.

Farërat duke mbartur elementet e përbashkëta, prapë në kohën e lulëzimit, me një gjendje superiore ndahen sipas urdhërit që kanë marrë; dhe elementet e ndryshme kur hyjnë nëpër drurë, ndahen dhe bëhen gjethe, lule dhe fruta. Ushqimet e ndryshme që hyjnë në

stomakun e njeriut, bëhen shqisa dhe organe të ndryshme. Pra shihni nëpër to si argument, fuqinë e Zotit xh.sh..

Fenomenet e shumta kur zotërohen lirë, duhet të jenë pa vlerë dhe pa rëndësi, ndërsa Fuqiploti me krijimet e shumta, në çdo krijesë po mbart vlera të shtrenjta. Tani si argument të çuditshëm shihet mjeshtria e Zotit nëpër tryeza dhe në frutin e mollës. Nëpër këto mjeshtri shihet mëshirën e Mëshirëplotit.

Tashmë në të gjithë sipërfaqen e tokës gjërat e vlefshme janë lirë; ato megjithëse të lira dhe komplekse, ndahen pastër; dhe edhe pse të largëta nga njëra-tjetra, përngjajnë dhe pajtohen së tepërmi. Përsëri duke qenë kështu të krijuara me kujdes, shumë lehtë dhe me projekte preçize, janë shumë të bukura dhe ekonomike. Pra tërësia e këtyre është padyshim si dita që tregon dritën dhe drita diellin. Edhe këto medoemos tregojnë fuqinë e Fuqiplotit Madhështor, Edukatën e të Gjithëdijshmit të përsosur dhe Njësimit të Gjithëmëshirshmit të Bukur.

Këto tregojnë sekretin e ajetit

(1) لَهُ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَى

Tani o ti injorant i pafat, i pakujdesshëm e inatçor dhe që nuk di të vlerësosh, me çfarë na i shpjegon këto? Ku i mbështet këto mjeshtri? Me ç'ka mund ta mbyllësh këtë dritare që është në madhësinë e rruzullit? Thirr rastësinë dhe shokun tënd të pavetëdije, pra natyrën në të cilën je mbështetur. A ka mundësi që këto sende të krijohen nga ato që po më thua, a nuk është njëqind herë e pamundur?! Këto punë superiore t'ia mbështesësh natyrës, a nuk është njëmijë herë e pamundur? Përndryshe, për të krijuar secilin send, natyra duhet të krijojë makina të shumëllojshme.


•

(1) أَوَلَمْ يَنْظُرُوا فِي مَلَكُوتِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ

Shiko këtë shembull që është edhe në “Fjalën e njëzetedytë”: Po qe se e sheh mjeshttrinë superiore në një vilë të bukur dhe të rregullt, me siguri ajo jep shenjën e punës së një mjeshtrit të ndërtesës dhe puna e përsosur tregon për një ekspert të kësaj fushe dhe një ekspert i një profesioni, mban cilësitë e funksionit të një fushe. Pra të gjitha punët që janë të përsosura, janë rezultat i shpirtit dhe i cilësive të përsosura. Njëlloj edhe këto mjeshtri që janë në sipërfaqen e tokës, bile edhe veprimet e rregullta dhe ato superiore, na tregojnë shumë qartë për një Mjeshtër gjenial, të cilat na japin shenjë për një Gjeni që titullohet më shumë Emra të Bukur dhe me funksione të jashtëzakonshme, sepse nuk është e mundur që një punë superiore të bëhet pa një rregullator. Po qe se në të vërtetë këto funksione të përsosura bëhen të njohura, atëherë me siguri ato janë shenjat e punëve, sepse titujt dhe emrat burojnë nga një funksion superior, që nuk lënë dyshim se kanë dalë nga qëllime të të zotit të funksionit dhe këto tregojnë se në të vërtetë është një Fuqiplotë që i bën këto. Tani universi ku duket kjo mjeshtri superiore, një nga një po jep shenjën e mjeshtrit, titullit dhe emrit. Emri i funksionit, ashtu siç dëshmon një nga një për një person dhe për Njësinë e një Mjeshtri të Madhërishëm, ashtu edhe tërësia e tyre dhe sasia e karvaneve të tyre është argument i paarritshëm që s’mund t’i afrohet kurrfarë dyshimi, për të mohuar mjeshttrin e tyre.

Tani o ti mohuesi i pakujdesshëm! Me çfarë mund ta thyesh këtë varg argumentesh që është i fortë në sasinë e qenieve? Këto dritare të argumenteve që janë si shoshë plot me vrima, me çfarë perdeje të pakujdesisë mund t’i mbyllësh?...

## DRITARJA E NËNTËMBËDHJETË



Mjeshtri i Madhërueshëm, planetet dhe yjet e qiellit i ka ngarkuar me aq dobi dhe me aq hijeshi, madje edhe me qenie të tjera të qiellit, si dhe me kuptime dhe qëllime që sikur edhe qiellin me vetëtimë e bubullimë dhe me pikat e shiut, i shtyn të flasin, duke treguar se nën këto nuk ka asnjë send pa dobi dhe larg mëshirës së Tij.

Ashtu siç e tregon kokën toka me anë të kaf-shëve e bimëve, duke treguar mjeshtëritë superiore të universit, ashtu edhe fjalët e asaj koke që janë gjethet, lulet e bimëve dhe frutat e pemëve, vazhdimisht lajmërojnë mjeshtërinë e Tij të përsosur dhe flasin bukurinë e mëshirës së Tij. Madje njerëzve të vetëdijshëm stërhollimet e mjeshtërisë së Tij, me fjalët e farërave të tyre i bën të ditur stërhollimet e Mjeshtrit të Vet.

Tani brenda këtyre shprehjeve dhe përmendjeve të panumërta, vetëm njërit prej tyre do t'ia vemë veshin dhe do ta mësojmë se si dëshmojnë ato.

Ja pra secila bimë dhe secili dru tregon mjeshttrin e tij dhe i çudit njerëzit e zgjuar. Dhe ata që shikojnë thonë: “Subhanallah, sa bukur dëshmon!” Pra secila bimë në momentin e lulëzimit dhe duke dhënë rezultatin e duhur e duke sqaruar buzëqeshjet shpirtërisht dhe duke i derdhur fjalët e përmendjes, zikrin, hijeshohen akoma më mirë. Goja e bukur e secilës lule, rezultati i saj dhe farërat e tyre që sajojnë një rregull preçiz të dijes superiore, këto zbukurime a nuk tregojnë një ekspert të paarritshëm. Erërat më të këndshme dhe ato më artistiket, tregojnë se janë dhurata të Një Bamirësi dhe Bujari të Gjithëmëshirshëm. Pra të gjitha këto, të cilat njëri brenda tjetrit mbartin mirësitë e kuptimit të plotë, janë ashtu një gjuhë dëshmimi ku me emrat e Tij të bukur “Esmā-ul Husnā”, tregojnë Mjeshttrin Madhështor, sqarojnë veprimet e funksioneve të Tij duke të shtyrë që edhe ti t'i duash dhe t'i njohësh ato.

Tani po qe se në një lule të vetme i ndjen këto dëshmi, vallë mendoje vetë se çfarë dëshmish mund të ndjesh nëpër vreshta dhe lulet hyjnore. Është një lumturi e madhe për ty po qe se mund t'i ndjesh se sa më zë të lartë bërtasin duke treguar nevojën e besimit tek një Mjeshtër i Madhëruar. Kështu tek ti nuk mbetet fare pakujdesi dhe dyshim. Edhe po qe se mbetet ndonjë dyshim, atëherë a është e drejtë që ty të thonë i vetëdijshëm?...

Tani ec në stinën e pranverës, shihe me kujdes një dru se si i dalin gjethet me rregulla superiore, si lulëzojnë me masa të preçizuara, si rriten frutat me mëshirë e me dije, si luhaten ato nëpër degë si fëmijët e pamëkatshëm kur fryn era; shihe gojën e tyre se si gjelbërohen me dorën e një Bamirësi, si qeshin gjethet e tyre, si shkëlqejnë ato me Mëshirën e Zotit kur shpallin gëzim, duke dhënë frutat e mëshirës së Mëshirëplotit, e si duket nëpër to masa, ekuilibri dhe zbukurimet superiore. A nuk duket përsëri në to bamirësia e mëshirshme dhe shija e ëmbël, po tek farërat a nuk duket mrekullia e Tij? Pra të gjitha këto medoemos na tregojnë me qartësinë më të madhe për Njësinë, Mjeshttrin e Gjithëdijshëm, Fisnikun e Mëshirës, Bamirësin Bujar, Bukurinë e Tij të mëshirshme dhe për Edukatën e Tij të përsosur.

يُسَبِّحُ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ

Tani në qoftë se mund t'i dëgjosh zërat e drurëve të rruzullit, do të shohësh se në thesarin e këtij ajeti “Çka ka në qiej dhe çka ka në tokë bën tesbih All-llahun”, çfarë xhevahirësh janë fshehur.

Tani o ti mosmirënjohës që beson se nuk ke për të dhënë llogari! Si mund të mos njohësh një Fisnik të Bukur që me gjuhëra të panumërta do të të njoftojë ty Vetën, por që ti nuk do ta njohësh?! Atëhere heshti këto gjuhë! Po qe se s'mundesh, dëgjoji pra! Se me pakujdesi duke mbyllur veshin nuk mund të shpëtosh veten. Se edhe po e mbylle ti veshin, universi nuk hesht; dëshmitarët e Njësimit nuk e ndërpresin zërin e tyre. Me të vërtetë ata ty të gjykojnë...

## DRITARJA E NJËZETË

(Shënim1)

فَسُبْحَانَ الَّذِي بِيَدِهِ مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ ۖ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ  
إِلَّا عِنْدَ نَاخِرَاتِهِ وَمَا نَزَّلَهُ إِلَّا بِقَدَرٍ مَعْلُومٍ ۖ

(Shënim): E vërteta e “Dritares së njëzetë”, në fillim më ka ardhur në zemër në arabisht, kështu:

لَمَّا أَضِيَاءُ مِنْ نُورِكَ تَشْهِيرِكَ تَمَوْجَ الْأَعْصَارُ مِنْ تَصْرِيفِكَ تَوْظِيفِكَ  
سُبْحَانَكَ مَا أَغْظَمَ سُلْطَانُكَ نَفْجَرُ الْأَنْهَارُ مِنْ نَدْحِيرِكَ تَسْخِيرِكَ  
نَزِينَ الْأَحْجَارُ مِنْ نَذِيرِكَ تَصْوِيرِكَ سُبْحَانَكَ مَا أَبْدَعَ حِكْمُكَ تَبَسُّمَ  
الْأَزْهَارُ مِنْ نَزِيلِكَ تَحْسِينِكَ نَبْرَجَ الْأَشْمَارُ مِنْ إِنْعَامِكَ إِكْرَامِكَ  
سُبْحَانَكَ مَا أَحْسَنَ صُنْعُكَ تَسْجَعُ الْأَطْيَارُ مِنْ انْطَافِكَ إِرْفَافِكَ  
نَهْرَجَ الْأَمْطَارُ مِنْ انْزَالِكَ إِفْضَالِكَ سُبْحَانَكَ مَا أَوْسَعَ رَحْمَتِكَ  
تَحْرَكُ الْأَقْسَارُ مِنْ تَقْدِيرِكَ نَذِيرِكَ تَدْوِيرِكَ تَنْوِيرِكَ  
سُبْحَانَكَ مَا أَنْوَرَبُرْهُانَكَ مَا أَبْهَرَ سُلْطَانَكَ

وَأَرْسَلْنَا الرِّيَّاحَ لَوَاحِجٍ فَأَنْزَلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً (مُبَارَكًا)  
(1) فَاسْقَيْنَا كُؤُهُ وَمَا أَنْتُمْ لَهُ بِمُخَازِنِينَ ۖ

Bukuria e arteve, duket në shesh jo vetëm në fenomene të mëdha, por në të vërtetë ajo

duket edhe nëpër gjëra të vogla, në pakica, në hollësira dhe në rezultatin e tyre, kurse imagjinata e rastësisë nuk mundet t'i sundojë këto gjëra që janë një mrekulli antike dhe artistike. Tani po shohim se drita me lejen e Zotit po shërben që të shihen mjeshtëritë hyjnore, d.m.th. fuqia hyjnore e All-llahut xh.sh. e ka shtyrë dritën t'u shërbejë gjërave antike të parashtruar në tregun e arshit të universit. Tani shumë gjëra konstatojnë dhe dëshmojnë se era kryen detyrën si shumë gjëra të tjera që bëjnë dobi prej Tij, domethënë nga Mjeshtri i gjithëdijshëm; vallzimi dhe endja e erës është një detyrim, shpenzim dhe përdorim. Pra vallzimi i erës është një përpjekje sa më e shpejtë ta kryejë detyrën ndaj Urdhëruesit.

Tani shiko 'çezmet' e lumenjve! A është e mundur që ato të burojnë rastësisht, sepse shumë fenomene dhe gjëra na dëshmojnë se nëpër male dhe kodra depozitimi i ujrave me një masë të caktuar, është një mëshirë e Mëshirëplotit. Ndërsa edhe në depozitim dhe shpenzimin sundon ekonomia; edhe kjo me siguri na tregon se nuk është një punë e rastësishme, me të vëtetë ajo bëhet me shpenzimin dhe me gjykimin e urdhërave të të Gjithëdijshmit. Madje edhe gurgullimet e burimeve të tyre nuk janë gjë tjetër vetëm se bindje ndaj urdhërave të All-llahut.

Tani shikoj llojet e gurëve, xhevahirëve dhe minierave të tjera! Hijeshimi i tyre dhe dhënia e cilësive të tjera të duhura, tregon se ato bëhen vetëm me anën e rregullimit, hijeshimit dhe formimit të një Mjeshtri të Gjithëdijshëm. Kështu vihet re se ato janë krijuar për një qëllim të caktuar, që të plotësojnë nevojat e njerëzve dhe të kafshëve. Tani shikoj lulet dhe frutat! Të qeshurat, shijet, bukuritë e zbukurimeve dhe erërat e tyre, a nuk janë nga një lajm ftese ndaj tryezave që është parashtruar nga Mjeshtri Fisnik? Ato me lloj-lloj shijesh dhe erërash të ndryshme na ftojnë tek ato sofa.

Tani shikoj shpendët! Shqiptimet dhe qukatjet e tyre të çuditshme ndaj njëri-tjetrit shprehin kuptimin e formës së bukur, pra biseda e tyre është një argument se një Mjeshtër i Gjithëdijshëm i sjell ato të bisedojnë dhe Ai në këtë mënyrë i ka frymëzuar ato.

Tani shikoj mjegullat! Gurgullimat e shiut nuk janë një zë pa kuptim, bile edhe zëri i vetëtimave dhe i bubullimave nuk janë zurma të kota. Argument i qartë për to është vlera e tyre që në një zbrazëti të madhe formohen në çast zërat e çuditshme dhe prej tyre milen pikat e ujit jetësor, duke rrjedhur sikur rrjedhin nga gjiri i nënës kur u jep të porsalindurve qumësht, njëlloj edhe pikat e shiut u arrijnë nevojtarëve të gjallë që janë nëpër tokë. Kështu ato gurgullima dhe bubullima mbajnë shumë kuptime të rëndësishme. Pra si ka mundësi që këto të bëhen vetvetiu, me të vërtetë ka shumë kuptim që Krijuesi ia çon nevojtarëve me urdhrin e Tij të Edukatës Fisnike; bërtitjet e shiut këtë duan të thonë se "po vijnë, sihariq-myzhde për ju".

Tani shikoj qiellin, planetet e ndryshëm, shikoj me kujdes hënën, lëvizja e së cilës është pikërisht në vendin dhe në kohën e caktuar. Këtë po e ndërpresim meqë e kemi sqaruar në vende të tjera.

Tani fillo prej dritës e deri tek hëna! Këto fenomene që rradhitëm janë një dritare e madhe që doemos na tregojnë për ekzistencën dhe për Njësimin e Zotit dhe që fuqia e Tij është e jashtëzakonshme.

Tani o ti i pakujdesshëm! Vetëm atëherë kur të heshtin këto zëra që tingëllojnë në qiell dhe kur të shuhen këto drita që janë si drita e diellit, ti mund ta harrosh Zotin, përndryshe mbliidhe mendjen dhe thuaj: “Subhane men” (Kush është Ai i Lavdëruari):

تُسَبِّحُ لَهُ السَّمَوَاتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ (1)

•

DRITARJA E NJËZETENJËTË

وَالشَّمْسُ تَجْرِي لِمُسْتَقَرٍّ لَهَا ذَلِكَ تَقْدِيرُ الْعَزِيزِ الْعَلِيمِ

Dielli që është një llambë e universit është një argument i fortë dhe i shkëlqyer për ekzistencën e Mjeshtrit të gjithësisë. Dymbëdhjetë\* planetet së bashku me rruzullin tokësor, ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri në madhësinë, shpejtësinë dhe pozicionin e tyre në hapësirë. Ato duke qenë se janë njëri lart e tjetri poshtë dhe shumë larg nga njëri-tjetri dhe në pozicione të ndryshme në lidhje me vetë diellin, gjë që është i lidhur me forcën tërheqëse të tij, lëvizin dhe sillen me një ekuilibër të rregullt dhe të përsosur, saqë asnjë çast nuk shpejtohen apo ngelin prapa.

Ligji i All-llahut është ai që i mban të lidhur ato me ‘imamin’ (prijësin) e tyre, diellin! Ja pra këto duke lëvizur në një hapsirë të gjerë pa asnjë aksident, a nuk janë duke dëshmuar fuqinë e Njësimit të Edukatorit Madhështor? Të bësh që të shërbejnë me një rregull të përsosur këto krijesa të pavetëdijshme dhe rruzuj të mëdhenj, është një argument që vërteton se kjo është vetëm puna e një Fuqiploti të Gjithëdijshëm.

Tani në këto punë të rënda e të mëdha, a ka mundësi të përzihet ndonjë grimcë e rastësisë? Po qe se përzihet rastësia, vetëm një krisje mund ta coptojë gjithësinë, sepse në një moment vetëm njëri prej këtyre planeleve të ndalet apo të shpejtësohet rastësisht, ai do të dalë në çast nga boshti i tij; mendoje vetë se sa e trishtueshme mund të jetë n.q.s. përplasen njëri me tjetrin planetet dhe trupat qillore që janë njëmijë herë më të mëdhenj se toka jonë.

Sjelljen e çuditshme të dymbëdhjetë planeteve të sistemit diellor po e lëmë në dijen e gjerë të Dijenisë Hyjnore dhe le ta kthejmë kokën që të shikojmë vetëm rruzullin në të cilin jetojmë. Toka jonë, që me urdhërin e Edukatorit Madhështor dhe me mbretërinë e mëshirës hyjnore rrotullohet me një rregull të përsosur për një shërbim të madh, e në një udhëtim të gjatë, duke u rrotulluar tregon dhe shpall një mrekulli të jashtëzakonshme. Siç e kemi treguar edhe në “Letrën e tretë”, ajo është një anije hyjnore që është plot e përplot me mjeshtëritë hyjnore dhe për njerëzit e vetëdijshëm një shtëpi e lëvizshme, një vegël e bukur për të shëtitur andej e këndej. Edhe hëna, duke u rrotulluar me një ekuilibër të hollë rreth Tokës, All-llahu xh.sh. ia ka lidhur botës për dobitë e shumëllojshme, duke e shtyrë të qarkullojë nëpër qiell.

Tani kjo gjendje e kësaj anije fisnike, a nuk është një argument i madh sa edhe vetë bota për të vërtetuar ekzistencën e Fuqiploitit të Madhëruar dhe ekzistencën e Njësimit të Tij?!

Meqë gjendja e botës është e tillë, mundeni ta krahasoni botën tonë me planetet e tjerë të sistemit tonë diellor. Të gjithë planetet që me urdhërin e Fuqiploitit janë të lidhur me diellin, marrin rrugë me shpejtësi të ndryshme, kurse toka rreth diellit sillet në një sekund sa njerëzit që ecin për pesë oprë, duke u larguar nga Yllësia e Herkulit. Kjo është me të vërtetë fuqia dhe urdhëri i Mbretit të pafillimit dhe të pambarimtë e Fuqiploitë, ku duke krijuar dhe sjellur këto krijesa, tregon madhërinë e Fuqisë së Tij. Kështu trupat e mëdhenj bëjnë manovra për të treguar fuqinë e Tij.

Tani o ti zotëri që merresh me astronomi fol vetë:

Cila rastësi mund të përzihet në këto punë? Cila dorë e ndonjë shkak mund të arrijë tek ato? Cila fuqi mund të afrohet tek ato? A ka mundësi që kjo Mbretëri e Madhërishtme të tregojë dobësi dhe në punën e Tij t’i bëjë shok vetes dikë?

Ai a e lë pas dore që ta marrin të tjerët veçanërisht frutin e gjithësisë, pra krijesat e gjalla që janë qëllimi, përmbledhja dhe rezultati i krijimit të universit?! A e lë kokëbosh veçanërisht frutin e përgjithshëm, përsosmërinë e rezultatit, mëkëmbësin e botës dhe mysafirin e Mbretit, pra njeriun?! Dhe këto, a ia jep natyrës apo rastësisë e të rrëzojë Sedrën e Mbretërisë së Tij dhe t’i zhdukë dobitë dhe bukuritë e Tij të përsosura?!

أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ مِهَادًا ﴿١﴾ وَالْجِبَالَ أَوْتَادًا ﴿٢﴾  
وَخَلَقْنَاكُمْ أَزْوَاجًا ﴿٣﴾ فَاَنْظُرْ إِلَىٰ آثَارِ رَحْمَتِ اللَّهِ  
كَيْفَ يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا ﴿٤﴾

Shiko rruzullin që është si një kokë me një qind gojë. Në secilën gojë ka një qind mijë gjuhë. Në secilën gjuhë mban një qind mijë argumente, që jo vetëm në një anë por në shumanshmërinë e tyre medoemos argumentojnë dhe dëshmojnë për ekzistencën e Tij dhe për Njësimin e një Fuqiploti të Madhërishëm që mban funksionet e të gjithë emrave të bukur, “Esmā-ul Husnā”.

Ja pra, po të marrim parasysh krijimin e parë të rruzullit tonë, ka qenë një materie e rrjedhshme dhe e lëvizshme, pastaj u ngurtësua dhe nga guri All-llahu i madhëruar atë e bëri dhë. Po të kishte mbetur lëng do të kishte rrjedhur kot; materiali i rrjedhshëm pasi është ngurtësuar, po të qëndronte i fortë si hekuri, s’do të bënte dobi. Pra duhet të mendojmë se kjo nuk u bë vetvetiu. Me të vërtetë Mjeshtri i Gjithëdijshëm i botës i ka dhënë gjendjen e duhur, bile i ka rregulluar edhe gjendjet e qenieve që jetojnë në të duke ua përballuar nevojat e tyre.

Më pas shtresat e tokës i ka vendosur mbi shtyllat e maleve që të marrë frymë që të qëndrojnë ndaj ngjarjeve të tërmetit që bëhet nga revolucionet e brendshme. Malet janë të detyruara që të mbrojnë botën duke mos prishur rregullin e Tij dhe ta shpëtojnë tokën nga sulmi i detrave; vetë malet bëhen thesare që të përballojnë nevojat e krijesave të gjalla, të pastrojnë ajrin që ta thithin të pastër krijesat e gjalla; madje malet kryejnë edhe depozitimin e ujrave dhe mineraleve që u duhen këtyre krijesave.

Tani këto gjendje që radhuam me lart na dëshmojnë medoemos se këto janë veprat e një Fuqiploti Absolut dhe e një Mëshirëploti të Gjithdijshëm.

O zotëri gjeograf! Me çfarë ma shpjegon këtë? Cila rastësi mund t’i rregullojë këto mjeshtëri të çuditshme që janë në anijen e Edukatorit, ku si në një ekspozitë të habitshme janë radhitur përmbi botën që sillet rreth diellit, duke bërë udhëtimin e njëzetekatërmijë vjetëve, ai e kalon për një vit pa e hedhur nëpër kozmos asnjërin.

Dhe shikoji mjeshtëritë e çuditshme që janë në sipërfaqen e tokës; shikoji elementet që kryejnë detyrën, hyjnë dhe dalin nëpër vendet e dhura dhe shërbejnë me urdhërin e të Gjithëdijshmit mysafirëve të Tij. Dhe shikoji këto vija të qëndisura të arteve të çuditshme që janë në sipërfaqen e botës, me lloj-lloj ngjyrash! Shikoji lumenjtë, detrat dhe malet se

si i ka bërë vendbanim dhe vegël transportimi të shumë banorëve të ndryshëm. Pastaj i ka shumëzuar dhe i ka hijeshuar me qindra mijëra lloje bimësh dhe kafshësh, duke u dhënë edhe jetë. Kohë pas kohe, me një rregull, duke i zbrazur me vdekjen i çliron dhe prapë i ringjall dhe i plotëson zbrazëtirat.

Pra këto vepra a nuk dëshmojnë medoemos për një Fuqiplotë Madhështor dhe për një të Gjithëdijshtëm të përsosur?

Shkurt, sipërfaqja e tokës është një vend ekspozimi për artet e çuditshme; një Mahsher i krijesave të mrekullueshme; një vendkalim i qenieve të gjalla dhe një xhami dhe vend qëndrimi i robëve të devotshëm. Kjo botë është dhe zemra e universit dhe për të vërtetuar njësimin e All-llahut xh.sh. mban aq argumente sa mban universi mashështorë.

Tani o ti zotëri gjeograf! Me këtë kokë të botës me njëqindmijë gojë dhe secila gojë më njëqindmijë gjuhë, All-llahu xh.sh. na njofton veten e Tij, por po që se ti Atë nuk e njeh, duke e futur kokën në pellgun e natyralizmit, atëherë mund ta mendosh vetë se sa gabim të madh ke bërë dhe mund ta krahasosh se sa dënim të rreptë ke merituar. Këtë mos e harro, zgjohu dhe duke nxjerrë kokën nga bataku thuaj:

(1) اَمَّنْتُ بِاللّٰهِ الَّذِيْ بِيَدِهِ مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ

•

DRITARJA E NJËZETETRETË

(1) الَّذِيْ خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيٰوةَ

Nga të gjitha mrekullitë “jeta” është më e bukura dhe më e shkëlqyera e Fuqisë së Edukatorit. Gjithashtu argumenti më i fortë dhe më i shkëlqyer për Njësimin e All-lahut të Madhëruar është “jeta”. Edhe bukuria e All-llahut pasqyrohet më shumë në të.

Ja pra, vetë jeta është ajo që me të gjithë funksionet e Emrave të Bukur të All-llahut, na tregon për një të Gjallë të Pavdekshëm, sepse jeta është një brumë dhe një dritë që na zbulon sekretet e shumë funksioneve të All-llahut, si në dritën që janë fshehur shtatë ngjyrat, ashtu edhe jeta është një e vërtetë që është krijuar nga shumë funksione të Zotit. Disa prej këtyre të vërtetave ndahen dhe me anën e shqisave zgjerohen duke lulëzuar.

Shumica e tyre e ndjejnë veten në formën e ndjeshmërive dhe dalin në shesh duke u bashkuar me shqisa dhe ndjeshmëri të tjera. Pra jeta qëndron në këmbë me anën e një Bujari që me mëshirën dhe ndihmën e Tij ia jep rrëskun dhe e furnizon atë. Kjo jep një kuptim se atje ku shkon rrësku, pra ushqimi, pas tij shkojnë edhe gjërat e gjalla, pra

rrësku ato i mban me vete. P.sh. në momentin kur jeta hyn në një trup, aty duket pasqyrimi i të Gjithëdijshmit, që me një dije superiore e ndërton strofkën e trupit. Në të njëjtin trup duket edhe funksioni Bujar, ku në atë trup Ai emër duket me të gjithë funksionet e tij, sqaron veten sipas nevojës. Sepse Ai shtëpinë e trupit të njeriut e rregullon duke e hijeshuar si jo më mirë. Prapë këtu në të njëjtin trup duket edhe pasqyrimi i emrit Mëshirëplotë, sepse Ai me mëshirën e Tij ia dhuron jetën me shumë lloj mirësish për të vijuar përsosmëria në të. Prapë në të njëjtin trup duket edhe shkëlqimi i Furnizuesit, sepse për të vijuar dhe lulëzuar, Ai ia sjell atij (trupit) ushqimet materiale dhe shpirtërore dhe disa prej tyre i depoziton në trup. D.m.th. “jeta” është një qendër dhe një pikë lëvizjeje në të cilën Zoti i ka përmbledhur shumë funksione, ku edhe shqisat marrin formë. Jeta është komplet një shkencë, në të njëjtën gjendje është edhe fuqi, në të njëjtën gjendje është edhe mentalitet dhe mëshirë.

Tani jeta me këto cilësi të përgjithshme bëhet një pasqyrë për qëllimin e personalitetit të Edukatorit. Nga ky sekret del që, medoemos duhet të pranojmë ekzistencën e Fuqiplotit, që Ai është i Gjallë, që nuk vdes kurrë dhe gjërat e gjalla i ka krijuar Ai dhe funksionet e tij janë jashtëzakonisht shumë. Dhe secilin send e mbledh rreth vetes dhe e shtyn t'i shërbejnë Atij, sepse gjallëria dhe jeta kanë detyra të mëdha. Ja pra për të bërë një pasqyrë të All-llahut duhet të shohim se çdo krijesë për çdo nevojë i drejtohet Atij. Kjo nuk është një punë e lehtë dhe detyrë e thjeshtë.

Tani shikoj këto gjallesa dhe origjinalin e tyre që janë shpirtërat e panumërt që kemi para syve, që në moment dalin në shesh nga asgjëja dhe veshin nga një trup, argument ky kaq i fortë, saqë si shkëlqimet që tregojnë diellin edhe sqarimet më të parëndësishme, medoemos tregojnë dhe na detyrojnë të besojmë Personalitetin e Gjallë që nuk vdes kurrë. Ato janë edhe argument për funksionet e Emrave të Bukur, “Esmā-ul Husnā”. Sikurse një njeri që nuk e njeh dhe e mohon diellin, bëhet e domosdoshme ta mohojë edhe dritën e shndritshme; njëlloj edhe kush mohon Njësimin e Zotit, që është i Gjallë dhe nuk vdes kurrë dhe që krijesat Ai i ngjallë dhe Ai ia merr shpirtërat, duhet të mohojë tërë krijesat që e mbushin faqen e tokës, e ndoshta duhet të mohojë edhe ardhmërinë, edhe të kaluarën dhe në këtë rast ai një qind herë duhet të rrëzohet nga vendi i lartë i njerëzimit dhe nga pozita e të gjallëve, e të bëhet një injorant i paskrupullt e fare i pashpirt.

## DRITARJA E NJËZETEKATËRT

(1) لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ لَهُ الْحُكْمُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ

Duhet të dimë se aq sa gjallëria dhe jeta, aq edhe vdekja është një argument për ekzistencën e Zotit dhe një shkak i fortë për të vërtetuar Njësimin e All-llahut xh.sh., me dëshmimin e ajetit kur'anor që thotë:

(2) الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ

Vdekja nuk është humbje, shkatërrim, ekzekutim, asgjë dhe zhdukje, por është një çlirim dhe bartje në banesa të tjera, një gëzim që vjen nga përfundimi i detyrave dhe shpëtim nga burgu i trupit. Në letrën e parë është treguar shumë mirë se vdekja është një vepër mentaliteti e të Gjithëdijshtimit.

Ja pra si mjeshtritë, krijesat dhe faqja e gjallë e dheut, që duken në rruzullin tonë, ato medoemos na dëshmojnë për Mjeshttrin e Gjithëdijshtëm dhe për Njësimin e Tij. Njëllor edhe me vdekjen e të gjallëve dëshmohet për të Gjallin e përhershëm dhe për Njësimin e Tij të pavdekshëm. Në “Fjalën e njëzetedytë” është argumentuar se vdekja është një argument shumë i fortë për Njësimin e All-llahut xh.sh.. Këtë çështje ia lëmë Atij dhe po sqarojmë vetëm njërën pikë të saj. Kështu që ashtu siç gjallesat me trupat e tyre medoemos tregojnë për ekzistencën e Zotit, ashtu edhe me vdekjen e tyre gjërat e gjalla tregojnë për ekzisencën e Njërit të pafillimtë dhe të pambarimtë. P.sh.: Sikurse në pranverë bota e gjallëruar me rregullin e gjendjes së saj tregon për mjeshttrin e saj, ashtu edhe kur po vdes në stinën e dimrit, kur mbulohet me qefinin e bardhë të borës, si të të vdekurve dhe njerëzit përnjëherë ia kthejnë shpinën botës me borë si ia kthejnë kufomës që nuk duan ta shohin dhe syri u shkon nga pranvera e kaluar që është bërë edhe ajo një kufomë dhe ajo e kaluara është duke treguar panoramën më të gjerë dhe më të bukur të pran-verës së ardhshme. Domethënë se secila pranverë e kaluar ka qenë e mbushur plot e përplot me mrekullitë superiore të Krijuesit, po ashtu prej të parave po kuptojmë se edhe pranverat e ardhmërisë do të jenë si ato të parat plot e përplot me mrekullitë e gjalla. Pra të gjitha këto, me një formë më të gjerë dhe më të shndritshme, medoemos na dëshmojnë për Mjeshttrin e Madhërishëm dhe për Fuqiplotin e përsosur që, Ai as ka lindur dhe as ka për të vdekur, se është “Dielli” i përjetshëm. Të gjitha këto me gjuhët e tyre shpirtërore, medoemos dëshmojnë duke thënë: “Besojmë All-llahun që është Një dhe i Vetëm”.

(1) وَيُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا

Shkurt, me sekretin e këtij ajeti, kjo botë e gjallë sikurse në pranverë dëshmon për

mjeshttrinë e Tij, edhe me vdekjen e saj në dimër ia kthen kokat njerëzve nga mrekullitë që janë rreshtuar në të dy krahët: në ardhmërinë dhe në të kaluarën. Në vend të një pranvere na tregon mijëra pranvera; në vend të një mrekullie të vetme na jep shenjë për mijëra mrekulli. Secila pranverë që ka kaluar është një argument më i fortë se kjo pranverë, është një argument i pranverave të ardhshme, sepse secili vit që pranvera ka kaluar në të kaluarën dhe ka shkuar me gjithë shkaqet e tij të dukshme, përveç tyre nga ana e shkaqeve të vdekura kanë ardhur të tjerët njëlloj si ato të parat. D.m.th. shkaqet e dukshme janë krijuar nga asgjëja, me të vërtetë ato i ka krijuar një Fuqplotë Madhështor dhe me gjithëdijen e Tij ato Ai i ka dërguar. Njëlloj edhe në të ardhmen që do të vijë, sipërfaqja e tokës do të jetë qëndisur me lloj-lloj lulesh dhe kjo dëshmon akoma më shumë për ringjalljen pas vdekjes sepse ato sërish Ai i krijon nga asgjëja dhe duke i detyruar i dërgon dhe i vendos në këtë botë dhe më pas edhe ato do të largohen.

Tani o ti natyralist i pakujdesshëm që je afruar të ngulçitësh në pellgun e saj! Kujt në të kaluarën dhe në të ardhmen nuk i arrin dora shpirtërore dhe kush nuk mban funksionin absolut, Ai si mund të përzihet në jetën e botës sonë? Si ka mundësi që ato punë t'i krijojë rastësia dhe natyra që janë nga një asgjë? Në qoftë se don të shpëtosh thuaj: “Natyra është një fletore e fuqisë së Zotit. Rastësia është një perde sekrete e Gjithëdijes Hyjnore për të na provuar ne”. Ti vetëm në këtë mënyrë mund t’u afroresh të vërtetave.

●

## DRITARJA E NJËZETEPESTË

Njeriu i rrahur jep shenjë për zullumqarin. Një vepër artistike është vepër e një mjeshtri. Një fëmijë jep shenjë për nënën e tij. E poshtira përkujton të lartën. Në gjërat e pakta dhe të shumta të gjithësisë, shohim mundësitë dhe ekzistencën. Në të gjithë punimet e dukshme të tyre janë shenjat e punës. Dhe në të gjitha gjërat e krijuara duket vula e krijimit që na tregon për Krijuesin. Dhe të gjitha shumëzimet dhe kompozimet janë nevojtarë të individit. Dhe ekzistenca, puna, krijimi dhe hijeshimi na tregojnë shumë qartë këto mundësi që duken sheshit në univers. Të gjitha punimet, të gjitha krijesat, të gjitha shumëzimet dhe kompozimet janë veprat e një All-llahu që është i lirë në punët e Tij dhe Krijuesi i të gjithëve.

Shkurt, si mundësia që na tregon për ekzistencën, përpunimi për punën dhe shumica për individin, ashtu edhe ekzistenca e shumicës përbëhet nga individët, pra edhe mjeshtria për Mjeshttrin e saj. Njëlloj edhe në këtë gjithësi, veprat e krijuara dhe qeniet e gjalla që ushqehen, na tregojnë për Mjeshttrin dhe Furnizuesin. Ekzistenca e këtyre funksioneve është një argument shumë i fortë për ekzistencën e Krijuesit, Furnizuesit, Mjeshtrit dhe Mëshiruesit. D.m.th. të gjitha qeniet, me qindra gjuhë të aftësisë së tyre cilësore medoemos tregojnë dhe dëshmojnë për qindra emra të bukur të All-llahut xh.sh., pra “Esmā-ul Husnā”-në. Po qe se dikush nuk i pranon këto dëshmi duhet të mohojë të gjitha aftësitë e cilësitë e qenieve.

## DRITARJA E NJËZETEGJASHTË(\*)

Qeniet e freskëta që shkojnë e vijnë nëpër faqen e universit tregojnë se janë shenjë dhe pasqyrim i Një të Bukuri që s'ka fillim apo mbarim. Ashtu siç shkëlqimi i fëshkërimave të pikave të lumit që vijnë njëri pas tjetrit, ku edhe të tjerat pasardhëse tregojnë pasqyrimin e diellit të përhershëm, po ashtu edhe kohërat dhe qeniet e shkuara, janë shkëlqimet e Një të Bukurit të paskajshëm, që japin shenjë për Të. Edhe dashuria e zjarhtë që është në zemër të gjithësisë, tregon për një të dashur që s'humbet kurrë. Ja pra një gjë që nuk gjendet në krijimin e drurit, në të vërtetë edhe në frutin e tij nuk mund ta gjesh atë.

Po ashtu edhe dashuria e sinqertë që është në univers tregon për dashnorin e saj, pra njeriun, por në forma të ndryshme gjendet dashuria e vërtetë nga zemra e gjithësisë, kjo dashuria e sinqertë tregon për të Dashurin e pambarim.


Edhe në gjoksin e të gjithëve që në forma të ndryshme shfaqen joshjet-forcat tërheqëse tregojnë për Njërin, që joshja-forca tërheqëse e Tij nuk soset kurrë. Madje edhe karvani i ndritshëm i krijesave (evlijatë), me transmetime tregojnë se me sytë e tyre kanë parë edhe gjërat e fshehta, e se ato me devotshmëri janë përballuar me shkëlqimin e të Bukurit të Madhërueshëm. Po kështu me të vërtetë ato dëshmojnë se edhe Zoti i Madhërueshëm do t'i njoftojë njerëzve Vetën e Tij. Edhe në faqen e gjithësisë dhe përmbi qeniet, punon lapsi i qën-disjes së mirësisë dhe hijeshisë, që tregon për bukuritë e Emrave të Bukur të Zotit të lapsit.

Tani bukuria përmbi gjithësinë dhe dashuria në zemrën e saj, joshja në gjoksin e saj, hulumtimi në sytë e tij, bukuria dhe hijeshija e përgjithshme, na hapin një dritare të madhe dhe të bukur. Dhe të gjithë Emrat e Bukur, zemrave të zgjuara u tregojnë për Bukurinë e të Madhërishmit dhe për të Dashurin që s'humbet dhe për të Adhuruarin e vërtetë.

Tani o ti i pakujdesshëm që je gati të mbytesh në pellgun e errësirës së materies dhe në fëlliqësiat e ndryshme e të ankthshme! Mblidhe veten, lartësohu me një formë që i ka hije njerëzimit dhe shiko nga këto katër anë dhe atëherë mund ta shohësh Njësimin e Bukur të Zotit; dhe fitoje besimin e pasosur e kështu mund të bëhesh njeri i vërtetë.

●

## DRITARJA E NJEZETESHTATË

(1) 

Duke shikuar shkaqet dhe krijesat e dukshme të universit, shohim se forca e shkakut më të lartë, nuk arrin tek krijesa më e thjeshtë, d.m.th. shkaqet janë një perde, ato i krijojnë tjetër kush. Si shembull nga artet dhe mjeshtëritë e panumërta, hetojmë aftësinë e

mbrojtjes së mendjes, pra kujtesën që është e vogël sa kokrra e grurit. E shohim se Fuqiploti në të i ka përmbledhur shumë libra, ndoshta është si një bibliotekë e madhe që pa i ngatërruar i ka regjistruar të gjitha ngjarjet e jetës së njeriut në të. Vallë cilin shkak mund të paraqitësh në krijimin e kësaj fuqie që është e mrekullueshme? A thua fijet deredhur e trurit, apo atomet e qelizave të thjeshta e të pashpirt i bëjnë këto punë? Apo fryma jote e rastësishme? Jo! Jo! Është e padyshimtë se atë e ka krijuar i Vetëm një Mjeshtër, që duke regjistruar në kokë me anë të kujtesës, të përkujton fletoren e madhe të punëve të të gjithë jetës dhe njeriu duke krahasuar me kujtesën që ka në kokën e vet, bindet se nuk janë harruar veprimet e jetës së tij.

Tani çështjes së kujtesës, mund t'i shtosh edhe të gjitha farërat dhe vezët, pastaj mendoji veprimet e këtyre gjërave të vogla dhe të pashpirt, që janë nga një mrekulli. Dhe rezultatin më të mirë e merr atëherë kur ta krahasosh edhe me krijesa të tjera, sepse secilën krijesë që e merr në dorë e sheh se është e krijuar me mjeshtri të paparamenduar e jo të thjeshtë si shkaku i saj. Ndoshta t'i mbledhësh të gjitha shkaqet së bashku, prapë do të tregojnë dobësinë e tyre ndaj Tij. P.sh. dielli që është një shkak i madh, po ta imagjinojmë se është me vetëdije e vullnet, dhe ta pyesim atë, “a ke mundësi të krijosh një mizë?”; me të vërtetë do të të thotë se: “Me lejen e Krijuesit tim, në ‘dyqanin’ tim ka shumë dritë, ngjyra dhe tempetaturë, por miza mban vegla interesante, të cilat në dyqanin tim nuk gjenden dhe as aftësia ime nuk i arrin, sepse miza ka sy, veshë, jetë e të tjera si këto.” Kështu krijesat që mbajnë mjeshttrinë dhe hijeshinë superiore, duke i refuzuar shkaqet, atyre u tregojnë Krijuesin. Me sekretin e ajetit

(1) **وَالِيهِ يُرْجَعُ الْأَمْرُ كُلُّهُ**

shkaqet, veprat e veta i mbështesin në fuqinë e Allahut të Madhëruar. Njëlloj edhe rezultatet, qëllimet dhe dobitë që janë lidhur me krijesat, me të vërtetë tregojnë se pas shkaqeve është një Edukator Fisnik i Gjithëdijshëm dhe Mëshirëplotë. Sepse shkaqet e pavetëdijshme nuk mbartin një qëllim të punës, ndërsa me siguri ato vijnë duke pasur shumë qëllime, shumë dobi dhe kuptime. D.m.th. ato i krijon dhe i dërgon një Zot Fisnik, që është i Gjithëdijshëm. Dobitë janë shkak për të ekzistuar krijesat. P.sh. për shiun a do të themi se shkaqet e krijuan atë? Ne a nuk e dimë se shkaqet nuk kanë mëshirë, nuk dinë se kafshët kanë nevojë të furnizohen dhe kanë nevojë për shi. D.m.th. atë punë e bën Ai që i ka krijuar kafshët dhe i di nevojat e tyre të furnizimit, sepse nevojat e tyre i ka marrë përmbi vete Ai Mëshirëploti që i ka krijuar ato. Madje shiu konsiderohet si “rahmet” (mëshirë), për arsye se mban shumë sekrete të mëshirës, që do të thotë se mëshira duke rënë pika-pika, ka marrë formën e shiut dhe bie nga një pikë.

Po ashtu edhe në fytyrat e qeshura të krijesave, bimët dhe kafshët e hijeshuara, medoemos na tregojnë se për të treguar bukuritë, pas perdes qëndron një Personalitet i Madhërueshem që është i Vetëm. D.m.th. hijeshija e çështjeve dhe gjendjet e tyre, janë patjetër për të të shtyrë që t'i duash ato dhe medoemos të shtyjnë t'i duash funksionet e Atij që është Bujar i Njohur, Mjeshtër dhe Fuqiplotë.

Shkurt, shkaku është shumë i thjeshtë dhe i dobët, atij ia mbështesin artet dhe krijesat që janë gjëra antike e shumë të vlefshme dhe për këtë arsye shkaqet i refuzojnë ato. Qëllimi dhe dobia e dukshme e krijesave, shkaqet i dorëzohen një Mjeshtri të Gjithëdijshtëm dhe aftësia e hijeshija e krijesave është një shenjë e qartë se Krijuesi i gjithësisë, me bukuritë e arteve, do që t'ua tregojë fuqinë e Tij dhe t'ua tregojë se i do ato.

O ti materialist! Me çfarë mund të m'i sqarosh këto tre të vërteta? Në qoftë se ke mend, shqyeji perdet e shkaqeve dhe thuaj: “Ai është i Vetëm dhe nuk ka shok”; dhe shpëto nga ankthet e panumërta.

•

#### DRITARJA E NJËZETETETË

وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافُ السِّنِّكُمْ  
(1)  
وَأَلْوَانِكُمْ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّلْعَالَمِينَ

Kur shikojmë gjithësinë shohim se që prej qelizës së një trupi dhe deri në të gjitha botërat, qartësohet rregullsi e mençuri. Së pari le të vë-rejmë qelizën e trupit, ku shohim se në të vepron Dikush që nevojat e saj i di dhe këto qeliza të vogla me ligjin e Tij i drejton. Në stomak gjenden rezerva ushqimesh në formën e një vaji të brendshëm, që shpenzohen ku është e nevojshme. Po ashtu edhe në ato qelizat e vogla ka depozitime minimale rezervash. Kur shikojmë bimët, shohim se ato kanë një formë shumë të rregullt. Kur shikojmë kafshët shohim se kanë forma shumë të përsosura dhe janë edukuar e ushqyer nga ana e një Fisniku. Trupat e mëdhenj të gjithësisë, sillen e rrotullohen duke shpallur Madhërinë e Zotit dhe gjithashtu ndriçojnë gjithësinë. Kur marrim parasysh komplet universin, e shohim atë në formën e një qyteti, apo një vile, ku shohim se është rregulluar dhe pajisur me qëllime të larta dhe vlera të mëdha.

Siç është sqaruar edhe në “shkallën e parë” të “Fjalës së tridhjetedytë”, duke filluar nga atomi e deri tek yjet e mëdhenj, nuk shihet ndonjë vend, që Zotit t'i përzihet ndonjë shok tjetër. Ato janë të lidhura me njëri-tjetrin në mënyrë të atillë që nuk mund t'i mbajë kush në dorë dhe t'i futë të gjithë yjet në shërbim të tij. Fjala dhe gjykimi i tij nuk ia kalon edhe në një atomi të vogël, sepse që t'i dalë zot një atomi të vogël, duhet t'i dalë zot të gjitha yjeve. Edhe këtë e kemi sqaruar në “shkallën e dytë” të “Fjalës së tridhjetedytë”, duke vërtetuar se kujt nuk i arrin fuqia në krijimin dhe rregullimin e qiejve, ai nuk mund t'ia vërë vulën e personalitetit të veçantë fytyrës së njerëzve. D.m.th. kush nuk është Zot i gjithësisë, ai nuk mund t'i vulosë njerëzit që të njihen se kush është. Po qe se të bëjnë sytë dritë shihe këtë dritare që është e madhe sa kjo botë. Me këto që treguam shihet më mirë kuptimi i ajeteve:

اللَّهُ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ وَكِيلٌ ﴿١﴾  
لَهُ مُقَالِدُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ

Pra siç e patë, kuptimi i saj shihet me sytë e mendjes dhe në faqen e madhe të universit. Meqë është kështu, atëherë mund të mohojë vetëm ai që nuk sheh, është i çmendur, apo nuk ka mundur të arrijë në shkallën e njerëzimit!

●

DRITARJA E NJËZETENËNTË

وَأَنَّ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ ﴿١﴾

Në një stinë pranvere po udhëtoja në një vend të huaj i zhytur në mendime. Duke kaluar përreth një kodre të vogël, më doli përpara një lule e verdhë dhe e shndritshme. Më përkujtoi lulet që kam parë në vendin tim që ishin tamam të të njëjtit lloj. Kështu zemra ime vërejti vulën e Atij që i ka qëndisur këto lule dhe në këtë rast me të vërtetë u binda se të gjitha lulet që janë nëpër tokë, bartin vulën dhe qëndisjen e All-llahut të Madhëruar. Pastaj përsëri mendova kështu: -Një letër që mban një vulë, tregon për të zotin e saj. Po ashtu njëlloj edhe kjo lule është një vulë e të Gjithëmëshirshmit. Madje edhe vetë kodra në të cilën jam, që është e qëndisur me lule me dekore të shumëllojshme, na tregon se edhe këto kanë dalur nga dora e Mjeshtrit të kësaj luleje. Po ashtu edhe vetë kodra është një vulë e Atij, bile edhe e gjithë fusha, e mori formën e letres së Mëshirëplotit. Pas kësaj mendova se secili send është nga një vulë e Zotit dhe ato e vërtetojnë se janë vula e sekretit të Tij.

Tashmë çdo send është një dritare e Njësimit të Zotit, që të gjitha çështjet ia jep Njësimit të All-llahut xh.sh.. Domethënë kush i ka vendosur këto dekorime në to, në secilin send, veçanërisht në qeniet e gjalla me qëndisje superiore dhe me mjeshtri të veçanta, Ai është Zoti i gjithësisë? Ai që të gjitha çështjet mund t'i krijojë është Ai që i ka krijuar edhe këto. D.m.th. kush nuk mund t'i krijojë këto, nuk mund të krijojë asnjë send.

Tani o ti i pakujdesshëm! Shihe fytyrën e gji-thësisë që njëra brenda tjetrës janë shkruar letrat e panumërta të Personalitetit të pambarim dhe mbi secilën letër mund të shohësh vulat e panumërta, vulosur nga ana e Njësimit të Zotit. Tani kush është ai burrë që i përgënjeshtrojnë të gjitha këto vula? Cila fuqi mund t'i heshtë ato? Sepse po ta dëgjosh secilin me veshin e zemrës, të thotë:

(1) أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ

•

## DRITARJA E TRIDHJETË

لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلِهَةٌ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا ﴿١﴾  
كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ لَهُ الْحُكْمُ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿١﴾

Në këtë dritare bëhet fjalë për gjërat e mundshme për të ekzistuar dhe që ekzistojnë, dritare e bulevardit të vërtetimit të ekzistencës së Zotit. Hollësirat e shpjegimit të kësaj çështjeje ia lëmë librave të mëdhenj të “Sherhul-mevakif” dhe “Sherhul-makasid”; dhe do të tregojmë vetëm dy rreze të kësaj dritareje që vijnë nga Kur’ani famëlartë.

Qënia kryetar e dikujt, nevojit që të mos ketë rival, pozita e tij e refuzon shoqërimin e detyrës dhe ndërhyrjen... Po të kishte fshati dy kryepreqë, do të prishej qetësia dhe rregulli i fshatarëve. Po kështu do të ndodhte edhe në një komunë apo krahinë më dy kryetarë po edhe në një prefekturë më dy prefektë punët do të ngatërroheshin. Edhe një shtet po të kishte dy mbretër shkatërrohet ai vend. Meqë tek njerëzit është diçka e tillë, e cila jep rezultat negativ, mendojeni vetë, se sa duhet të refuzohet ndërhyrjen e dikujt tjetër në punët e Zotit, Sundimtarit dhe Fuqiplotit Absolut të gjithësisë. Domethënë, nevoja më e madhe e Edukatës Hyjnore është Njësimi dhe Vetja e Tij Hyjnore. Për këtë argumenti më i madh është rregulli dhe rryma e përsosur që vijon në univers, duke filluar që nga krahu i një mize të vogël e deri tek yjet që janë qirinjtë gjigandë të qiellit, para të cilit nga habija mendja njerëzore nuk di se çfarë të bëjë tjetër, veçse të thotë: “Subhanallah, Mashaallah dhe Barekallah!” (All-llahu është i Patëmeta, me dëshirën e All-llahut janë bërë, All-llahu i ka madhëruar ato).

(1) لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلِهَةٌ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا

Me shenjën e këtij ajeti, po qe se gjendet sa një grimcë e vogël vend për shoqërim që të bëhet ndërhyrje, prishet rregulli i gjithësisë, i ndërrohet forma, e atëherë dalin në shesh shenjat e kijametit. Ndërsa në shprehjen dhe shenjën e këtij ajeti thuhet:

فَارْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَى مِنْ فُطُورٍ ﴿١﴾ ثُمَّ ارْجِعِ الْبَصَرَ كَرَّتَيْنِ  
يَنْقَلِبْ إِلَيْكَ الْبَصَرُ خَاسِئًا وَهُوَ حَسِيرٌ ﴿٢﴾

Shikoni universin! A do të mundet syri juaj të gjejë diçka mangut? Sigurisht që nuk është e mundur, asgjë nuk mund të gjejë, e mjerisht syri i hetuesit, i lodhur do të kthehet prapë dhe do t'i thotë mendjes duke e kritikuar, që s'ka asnjë mangësi. Me këtë po duket se sistemimi dhe rregulli i universit, është i përsosur, d.m.th. rregulli i gjithësisë është dëshmitari më i madh i Njësimit të All-llahut xh.sh..

Tani të marrim parasysh “Ekzistencën”. Filozofët kanë thënë se Universi në fillim u shndërrua dhe pastaj u bë. Sigurisht çdo send duhet ta bëjë dikush. Pra shpikësi i të gjithëve është pa parafillim. Ne u themi kështu: -Me të vërtetë që gjithësia është e krijuar më vonë. Sepse shohim se në çdo shekull, bile çdo vit dhe çdo stinë, një botë shkon e një tjetër vjen (bota e bimëve, etj.). D.m.th. ekziston një Fuqplotë që gjithësinë e krijon çdo vit, stinë, e ndoshta çdo ditë e krijon nga asgjëja. Këto e ndjekin njëri-tjetrin si zinxhir, duke ia bashkangjitur shiritit të kohës. Me të vërtetë po shohim me sytë tonë se si universi i përsëritshëm po vjen çdo stinë, pra këto medoemos i krijon një Fuqplotë Madhështor. Me të vërtetë All-llahu i Madhëruar që bën shndërrime brenda gjithësisë, patjetër edhe këtë botë e ka krijuar dhe e ka bërë si bujtinë për mysafirët e ndershëm.

Të vijmë tek “mundësia”. Prapë filozofët e fesë islame kanë thënë se:

Mundësia është “Mutesavijjut-tarafejnë”, d.m.th. “ekzistenca” dhe “mundësia” po qe se bëhen të njëjta, atëhere atyre u duhet Caktuesi, Parapëlqyesi dhe Shpikësi, sepse mundësitë nuk mund të shpikin njëra-tjetrën.

Meqë është kështu, medoemos ekziston një Zot që i shpik këto. Dijetarët e kanë hedhur poshtë “krijimin nga shkaqet” me dymbëdhjetë argumente të sakta, duke e parë të pamundur dhe kanë thënë se ekziston një Zot xh.sh.. Në këtë çështje ne themi se argumenti më i bindshëm është kur në të gjitha sendet vërtetohet vula e Krijuesit të gjithësisë. Ja pra me frymëzimin e Kur'anit, të gjitha “dritaret” dhe “Fjalët” e Risale-i Nurit, kanë rrugën që u treguam më parë. Megjithatë mundësia është shumë e gjerë, që me shumë pika, medoemos dëshmohet dhe tregohet se ekziston një Zot. Mendimi i filozofëve islamë që paraqesin për ndërprerjen e rikrijimit, është një rrugë e ngushtë; kurse për njoftimin e All-llahut rrugët janë të panumërta. Kështu që po shohim se çdo send, në ekzistencën e tij si me aftësi ashtu edhe në jetën e tij, duke patur alternativa të panumërta, trupi i tyre merr formën më të bukur. Edhe aftësitë e tij ua ka dhënë sipas gjendjes, madje në tërë jetën e tij përballohet me shndërrime, funksione dhe aftësi të pëlqyeshme. D.m.th. ato po bëhen me qëllimin e një Eksperti dhe parapëlqimin e një të Dijshmi dhe me gjithëdijen e një Shpikësi. Meqë nga shumë alternativa parapëlqehet një rrugë më e mirë dhe pajisen me mjete të përsosura, mbrapa njërit prej tyre nxirret nga

grupi i individëve, kompozohet dhe bëhet një pjesë e trupit dhe në atë trup duket se mundësitë po shtohen dhe po përfiton aftësi që të futet në mijëra forma. Duke patur mundësi ta marrë formën pa farë rezultati, Një Fuqplotë i ka dhënë atij një formë të veçantë, që në trupin ku ka hyrë të kryejë detyra të rëndësishme, duke u ndërtuar në atë trup diçka tjetër. Mundësitë shtohen dhe një atom i vogël mund të marrë pjesë nëpër mijëra trupa. (Pra këtu bëhet fjalë që ushqimet nga gjërat e pajeta, marrin jetë në trupin e njeriut. shën. i editorit).

Tani a e pe se nga mijëra alternativa si i jepet atij forma më e bukur, e me to ka mundësi të kryejë detyra të rëndësishme dhe vijon... E duke vazhduar sa më tepër medoemos tregon për Rregulluesin dhe të Gjithëdijshmin. Pra kjo sigurisht tregon se është duke drejtuar me urdhërin e një Gjykatësi të Dijshëm. Trupi brenda trupit, pjesa brenda pjesës, të cilat qarkullojnë në të gjitha kompozimet, i përngjajnë një ushtari që ka marrë pjesë në brigadë, në batalion, në regjiment, në divizion dhe në ushtrinë e tij shteti, duke bërë një shërbim të rregullt.

Ashtu siç edhe qeliza e bebes së syrit tënd, së pari ka një detyrë në sy, po ashtu edhe në të gjithë kokën tënde ka detyra dhe shërbime të ndryshme. Po qe se ajo qelizë bën një gabim të vogël, qoftë edhe sa atomi, prishet drejtimi i shëndetit, sepse ai atom i vogël edhe nëpër damarët e gjakut, nëpër ndjeshmërinë e nervave deri edhe në të gjitha anët e trupit, ka një detyrë të veçantë. Nga mijëra alternativa, detyrat më të bukura ua ka dhënë qelizës dhe atomeve të saj. Njëlloj edhe secilës qenie të këtij universi, nga shumë alternativa, i ka dhënë funksionet, aftësitë e veçanta dhe formën e dobishme. Këto tregojnë dhe dëshmojnë për ekzistencën e një Zoti të Gjithëdijshëm, që ka vullnet të fortë, sepse Krijuesi për të mbrojtur interesin e atomit më të vogël, i ka dhënë kontaktin me kompozimet. D.m.th. një gjë e vetme me gjuhët e saj të panumërta, dëshmon Atë. Tani argumenti nuk është i sa universi, por sa funksionet e qenieve që janë në univers dhe sa kompozimet e tyre që medoemos tregojnë dhe dëshmojnë për ekzistencën e All-llahut xh.sh..

Tani o ti i pakujdesshëm! Të mos dëgjosh këto dëshmi dhe këto zëra që e mbushin gjithësinë, mendoje vetë se sa shurdh dhe i çmendur mund të jesh.

•

DRITARJA E TRIDHJETENJËTË

لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ ﴿١﴾ وَفِي الْأَرْضِ  
آيَاتٌ لِلْمُوقِنِينَ ﴿٢﴾ وَفِي أَنْفُسِكُمْ أَفَلَا تُبْصِرُونَ ﴿٣﴾

Kjo dritare është dritarja e njeriut dhe është objektive. Meqë është kështu, hollësinë e kësaj dritareje po e lëmë në librat e mijëra evlijave dhe dijetarëve të devotshëm. Ne këtu

do të sqarojmë disa themele që i kemi marrë nga frymëzimi i Kur'anit famëlartë. Kështu që siç është sqaruar edhe në “Fjalën e njëmbëdhjetë”; “Njeriu është një kopje e përgjithshme që të gjitha emrat e Tij, Zoti i Madhërueshëm, me ekzistencën e njeriut, ia interpreton atij. Hollësitë e kësaj teme po ia lëmë librave të Risale-i Nurit, kurse këtu do të tregoj vetëm tre pika.

Pika e parë: Njeriu është pasqyrë e Emrave të Zotit, në tre anë.

E para: Si na tregon nata ditën ashtu edhe njeriu me dobësinë e tij, me varfërinë e tij, me nevojat që ka dhe me mangësitë dhe gabimet e tij, duke i pasqyruar tregon për fuqinë e Fuqiplotit Madhështor dhe për të Pasurin e Mëshirshëm dhe vazhdon... Në këtë mënyrë pasqyron Funksionet Hyjnore. Derisa njeriu me dobësitë e tij, për t'iu bërë ballë armiqve duke kërkuar mbështetje, kthehet nga Zoti i Madhëruar dhe me varfërinë e tij, duke qenë i gulçitur me nevoja të panumërta dhe me qëllime të shumëllojshme, bëhet e domosdoshme që të kërkojë një pikë mbështetje; pra ndërgjegja e tij në atë pikë që është mbështetur duke u lutur, gjen shpëtim. D.m.th. çdo zemër duke u mbështetur dhe kërkuar ndihmë tek Ai, asaj i hapen dy dritare për të bërë dobi nga mëshira e Fuqiplotit.

Ana e dytë e pasqyrimit janë mostrat që të njihen funksionet e All-llahut xh.sh., pra dituria e pakët, fuqia, shikimi, dëgjimi, zotërimi i pronës dhe vullneti i sundimi të pakët që janë tek njeriu. Me këto funksione të vogla i njeh funksionet e Zotit të gjithësisë, që të dëshmosh dhe të bëhesh pasqyrë e dijes, fuqisë, shikimit, dëgjimit dhe Gjykimit dhe Edukatës së Tij Absolute; me ato ekuilibre të vogla i kupton funksionet e mëdha të Fuqiplotit. P.sh. kur thua: si e krijova unë këtë shtëpi, si di të krijoj, si jam i zoti i saj dhe si e drejtoj atë? Njëlloj edhe me to kupton se me siguri edhe kjo vilë e universit ka një Mjeshtër. Ai Mjeshtër atë e di, e sheh, e krijon dhe e drejton...

E treta anë e pasqyrimit janë qëndisjet e veglave të njeriut që i ka pajisur Ai. Me ato njeriu dëshmon dhe pasqyron emrat e funksioneve Hyjnore. Në fillim të pjesës së tretë të “Fjalës së tridhëtdytë”, kemi sqaruar se mbi shtatëdhjetë emra të Zotit janë dekorimet e qarta tek kompleti i njeriut. P.sh. në krijimin e njeriut, emrat Mjeshtër, Krijues dhe Bukuri, tregojnë emrat e një të Gjithëmëshirshmi e Mëshirëploti dhe nga edukimi i bukur i njeriut, shihen funksionet e Fisnikut të Bukur dhe në vazhdim...

Të gjitha shqisat dhe veglat që janë pajisur me elemente të shumëllojshme ndjeshmërie e shpirti, dëshmojnë për emrat e ndryshëm dhe qëndisjet e ndryshme. D.m.th. sikurse të gjitha Emrat e Zotit kanë edhe një gradë më të madhe, ashtu edhe funksionet e tyre të qëndisjes mbajnë nga një gradë të madhe të qëndisjes!

Pika e dytë: Jep shenjë të sekretit të rëndësishëm të njësimi të Zotit të Madhëruar. Shpirti i njeriut ka lidhje me të gjithë trupin e tij, ku të gjitha veglat e trupit i shtyn të vrapojnë në ndihmë të njëra-tjetrës. Pra shpirti i njeriut është ai që ka ardhur nga shkëlqimi i vullnetit hyjnor, që ka rrjedhur nga urdhëri i ligjit të Edukatorit, që thotë: “Bëhu, e në çast bëhet.” Pra shpirti ndikon në drejtimin e veglave të trupit kur dëgjojnë zërin shpirtëror të njëri-tjetrit dhe kur vrapojnë në ndihmë të njëri-tjetrit. Shpirti duke qenë mes tyre nuk i pengon ato, nuk i ngatërron; për shpirtin janë njëlloj e largëta me të

afërmen... Nuk u bëhet perde njërit apo tjetrit, kur të dojë shumicën i sjell në ndihmën e njërit, kur të dojë e di, e ndjen dhe i drejton veprat e të gjitha veglave të trupit. Derisa, n.q.s. i zoti i tij është i devotshëm me secilën pjesë të trupit, mund të shikojë dhe të dëgjojë, njëloj me ajetin kur'anor që thotë: “Shembujt e All-llahut janë më të latë”. Meqë shpirti është një ligj i urdhërit hyjnor, që me gjendjen e tij, pra në botën e vogël, tek njeriu është duke treguar veprimet superiore, me të vërtetë vullnetit të Tij të përgjithshëm dhe fuqisë së Tij absolute, nuk i vjen vështirë që t’i kryejë punët e panumërta, t’i dëgjojë zërat dhe lutjet e pallogaritshme. Për Krijuesin e Madhërueshëm nuk është një angazhim, asnjëri nuk i bëhet peng që ta shohë apo dëgjojë zërin e tjetrit, përnjëherë të gjitha i sheh, përnjëherë i dëgjon zërat e të gjithëve; të largët dhe të afërt, për Të janë të njëjtë. Po të dojë të gjithëve i dërgon në ndihmë të njërit. Me secilin send mund të shohë secilin. Përnjëherë mund t’i dëgjojë të gjithë zërat. Çdo send e di...

Pika e tretë: Jeta është shumë e rëndësishme. Me veprat që bën jeta, mban vlerë të madhe. Kjo temë ka kaluar edhe në “dritaren e jetës” dhe në “Fjalën e njëzetekatërt”, ku është treguar hollësisht, prandaj këtu vetëm po vërejmë se:

Në jetën e njeriut ku valojnë ndjeshmëritë të ndërthurura me njëra-tjetrën, janë shenjat e emrave të Zotit të Madhërueshëm, janë pasqyrë e punëve të shkëlqyera të një të Gjalli që nuk vdes kurrë. Tani po e mbylлим këtë derë për arsye se nuk ka ardhur akoma koha që të sqarohet mirë ndaj ateistëve dhe atyre që nuk pohojnë.

## DRITARJA E TRIDHJETEDYTË

هُوَ الَّذِي أَرْسَلَ رَسُولَهُ بِالْهُدَىٰ وَدِينِ الْحَقِّ لِيُظْهِرَهُ عَلَى الدِّينِ  
كُلِّهِ وَكَفَىٰ بِاللَّهِ شَهِيدًا ﴿١﴾ قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ  
اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ  
لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ يُحْيِي وَيُمِيتُ <sup>(1)</sup>

Kjo dritare është e diellit, e të Dërguarit a.s., dritartja e Hz. Muhammedit Alejhisselam, i cili është dielli i diejve.

Këtë dritare të madhe dhe të shndritshme, po ia lëmë fragmentit të Miraxhit që titullohet “Fjala e tridhjetënjtë” dhe tregon për Dërgueshmërinë e Ahmedit (Alejhissalatu vesselam), si dhe në “Letrën e njëmbëdhjetë”, me njëmbëdhjetë shenja është sqaruar se jeta e profetit Muhammed, është tepër e vlefshme dhe e shndritshme. Këtu për të vërtetuar Njësimin e All-llahut, do të tregojmë argumentin që flet për jetën e Muhammedit (Alejhissalatu vesselam), sepse ai i ka bashkuar Profetësinë bashkë me mrekullitë e evlijallekut, pra ai është një argument i madh, që atë e kanë vërtetuar të gjithë profetët të cilët kanë ardhur para Tij, së bashku me të gjithë evlijatë që kanë ardhur pas. Ai në të gjithë jetën e tij, me të gjithë forcën e vet, duke treguar Njësimin e Zotit, ka shpallur fenë islame, dhe duke i njoftuar Zotin popullit, ka hapur një dritare të madhe si imam Gazaliu, imam Rabbaniu, Muhjiddin Arabiu dhe Abdulkadir Gejlaniu dhe miliona dijetarë të vërtetë dhe të pastër, të gjithë e kanë vërtetuar atë. Vallë a ka ndonjë pëlhurë të trashë që e mbyll këtë dritare të madhe?! A ka mundësi që dikush duke kritikuar me ankth, të mos e shohë nga dritarja atë?! N.q.s. “po”, a s’është i çmendur ky? Fol ti vetë!

## DRITARJA E TRIDHJETETRETË

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَى عَبْدِهِ الْكِتَابَ وَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عِوَجًا قِيمًا ﴿١﴾  
الرَّكِتَابِ أَنْزَلْنَاهُ إِلَيْكَ لِتُخْرِجَ النَّاسَ مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ

Ja pra mendoje se të gjitha dritaret e kaluara janë nga një pikë e detit të Kur'anit famëlartë, e atëherë mund ta kuptosh se Kur'ani është plotë me argumente për të vërtetuar Njësimin e All-llahut xh.sh.. Duhet të dimë se burimi, miniera dhe themeli i të gjitha dritareve është Kur'ani, edhe në qoftë se e shikon Atë me syrin e thjeshtë, prapë është një dritare e gjerë dhe e përgjithshme. Dhe për të parë se kjo dritare është e saktë dhe e shndritshme, duhet t'i referoheni “Fjalës së njëzetepestë”, e cila tregon mrekullitë e Kur'anit dhe “Shenjën e tetëmbëdhjetë” të “Letrës së nëntëmbëdhjetë”. Gjithashtu duke ia mbështetur Mëshirës së lartë të All-llahut të Madhërishëm dhe zbritjes së Kur'anit Famëlartë, i lutem duke thënë:

رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا  
رَبَّنَا لَا تَزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا  
رَبَّنَا تَقَبَّلْ مِنَّا إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ  
وَتُبْ عَلَيْنَا إِنَّكَ أَنْتَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ ﴿١﴾

Vërejtje:

Këto dritare që janë të “Letrës së tridhjetëe-tretë”, kush nuk i beson inshaall-llah atë e shtyjnë të besojë; po kush e ka besimin e dobët ia forcon besimin dhe kush ka besim të fortë, ia forcon me të vërteta, kush e ka besimin e vërtetë, atij ia zgjeron dhe kush e ka besimin e gjerë, ai përparon në njoftimin e Zotit, pozitë kjo që është shkaku i të gjithë përparimit dhe lartësimi, duke i hapur horizontet e shndritshme.

Tani për këtë arsye askush të mos thotë se “mua më mjafton një dritarë që lexova”, sepse në qoftë se mendja jote e ka marrë pjesën e saj edhe zemra do pjesën e vet, edhe shpirti

do pjesën e tij, derisa edhe imagjinata jote do të marrë dritë nga ajo. Në këtë mënyrë çdo dritare të sjell dobi të ndryshme..

Në fragmentin e Miraxhit, para vetes kemi pasur besimtarë, mosbesimtarët kanë qenë në gradë të dytë, por në këtë vepër kemi qenë përballë ateistit, besimtarët kanë qenë në pozitën e dëgjuesve. Vlerësimin e bëni sipas kësaj mase. Por fatkeqësisht ky libër kaq i rëndësishëm, është shkruar me një shpejtësi të jashtëzakonshme, bile ka mbetur me dorëshkrimin e parë të pakorigjuar. Nga lexuesi kërkoj tolerancë dhe të luten tek All-llahu i Madhëruar për faljen e gabimeve të mia.

وَالسَّلَامُ عَلَىٰ مَنْ اتَّبَعَ الْهُدَىٰ  
وَالْمَلَأَ عَلَىٰ مَنْ اتَّبَعَ الْهُوَىٰ ❁

سُبْحَانَكَ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ أَعْلَمُ الْغُيُوبِ

اللَّهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلَىٰ مَنْ أَرْسَلْتَهُ رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ  
(1) وَعَلَىٰ آلِهِ وَصَحْبِهِ وَسَلِّمْ أَمِينَ